

UNIVERSITETI I

EJL

УНИВЕРЗИТЕТ

НА ЈИЕ

SEE UNIVERSITY



FAKULTETI

JURIDIK

ПРАВЕН

ФАКУЛТЕТ

LAW FACULTY

STUDIMET PASDIPLOMIKE-CIKLI I DYTË

DREJTIMI: STUDIME TË SIGURISË

TEZA E MAGJISTRATURËS

TEZA E MAGJISTRATURËS:

**“Ekspansioni i krimit të organizuar nacional dhe trans
nacional, perceptimet, qëndrimet e opinionit publik të Kosovës”**

KANDIDATI:

Andi Morina

MENTORI:

Prof. as. dr. Besa Arifi

Tetovë, 2021

Shkurtesat:

ACT	Mjetet Anti-falsifikim
AML	Pastrimi i parave
AST	Stimuluesit e tipit amfetaminë
BPD	Fuçi në ditë
CFT	Luftimi i financimit të terrorizmit
CITES	Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare në llojet e faunës së egër dhe florës
DTO	Organizata e trafikut të drogës
EZZ	Zonë ekskluzive ekonomike
BE	Bashkimi Evropian
EUC	Certifikata e përdoruesit përfundimtar
FAO	Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara
FATF	Task Forca e Veprimit Financiar
FBI	Byroja Federale e Hetimit
FIU	Njësia e Inteligjencës Financiare
FSI	Indeksi i Fshehtësisë Financiare
GFI	Integriteti Global Financiar
GLEI	Identifikuesi i personit juridik global
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
IMO	Organizata Ndërkombëtare Detare
IP	Pronë intelektuale
ISIS	Shteti Islamik në Irak dhe Levant
LRA	Ushtria e Rezistencës së Zotit
SKP	Substanca të reja psikoaktive
OCG	Grupi i Krimit të Organizuar
OECD	Organizata e për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
RUF	Fronti i Bashkuar Revolucionar
SALE	Armët e vogla dhe të lehta
TBML	Pastrimi i parave bazuar në tregti
TJN	Rrjeti i Drejtësisë Tatimore
TOC	Krimi i organizuar trans nacional
OKNB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNEP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin
UNITA	Bashkimi Kombëtar për gjithësi për Pavarësinë e Angolës
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimet
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
UVI	Identifikues unik i anijeve
TVSH	Taksa e Vlerës së Shtuar
WCO	Organizata Botërore e Doganave
NJIF	Njësia e Inteligjencës Financiare
PEP	Persona të Ekspozuar Politikisht
FATF	Task Force për Veprimin Financiar për Pastrimin e Parave
TQNJ	Trafikimi me qenie njerëzore
IUU	Peshkimi i paligjshëm, i pa raportuar dhe i parregulluar
NJP	Portali Kombëtar i Punës

Lista e Tabelave:

Tabela nr.1. Krimi i organizuar trans nacional fitimi brenda nje viti.....	28
Tabela nr. 2. Përmbledhje të vlerave të tregut global për të gjithë trafikun e drogës....	29
Tabela 3. Rrugët e trafikimit te drogës.....	30
Tabela 4.Trafikimi i drogës.....	31
Tabela 5. Çmimet dhe Distanca: Kokaina Kolumbiane (US- \$, rrugë me shumicë).....	32
Tabela 6. jep një përshkrim të përbërësve të ndryshëm të armëve të paligjshme.....	32
Tabela 7. Kostoja mesatare e një AK-47 në të gjithë botën (US \$.).....	39
Tabela 8. Observatori Global mbi Donacionin dhe Transplantimin Shikoni Shtojcën, Seksionin C për një listë të burimeve për çmimet e shitjes me pakicë.....	40
Tabela nr.9. J. Kidney, Transplantet e veshkave: Shitësit kundër Marrësit.....	41
Tabela K-10. Çmimet e paguara për shitësit e veshkave në të gjithë botën.....	42
Tabela nr. 11. Vjedhjet dhe shitjet e veprave të shquar të Artit.....	49
Tabela nr.12. Tregtia me mallra të falsifikuar dhe pirateria, 2017 (US \$).....	49
Tabela 13. Tregtia e mallrave me pirat digjital, 2015 (US-\$).....	50
Tabela 14. Shembull i çmimeve të tregut me pakicë-Online (US \$).....	53
Tabela 15. Konfiskimet nga Policia e Kosovës për gjatë viteve 2012 – 2015.....	56
Tabela 16. Numri i rasteve që ndërlidhen me veprat penale të Trafikimit me njerëz gjatë viteve 2012 – 2015.....	57
Tabela 17.Veprat penale të korrupsionit periudha kohore 2012-2015.....	58
Tabela 18 - Statistikat e veprës penale Pastrim i parasë 2012-2015.....	63
Tabelari 19.Vlerat me pakicë e krimit të organizuar ndërkombëtar.....	84
Tabela 20. Vlera me pakicë e Krimit Transnacional për një vit.....	88

Lista e Grafikoneve:

Grafikoni nr. 1. Fitimet vjetore të vlerësuar nga trafikimi me qenie njerëzore sipas rajoneve (miliardë dollarë amerikanë).....	36
Grafik. Nr.2.Fitimet Vjetore nga Trafikimi i Njerëzve nga Sektori (miliarda dollarë amerikanë).....	37
Grafikani. 3. Përfshinë punë të brendshme dhe jo shtëpiake.....	58
Grafkoni 4 - Viktimat e Trafikimit sipas grup-moshave 2012-2015.....	60
Grafiti 5. Trendi i kërkesave për azil në vendet e BE-së nga shtetasit e Kosovës Prill 2014 Qershor 2015.....	61
Grafikoni 6 - Kontrabanda e derivateve (Nafta, Benzina, Vajra motorik/hidraulike), viti 2012 - Tetor 2015.....	62
Grafikoni 7 – Numri i rasteve të kontrabandimit të medikamenteve mjekësore periudha kohore 2012-tetor 2015.....	62
Grafikoni 8- Sasia e cigareve të kontrabanduara 2012 – tetor 2015.....	69
Grafikoni nr. 9. Si i vlerësoni veprat e kryera nga krimi i organizuar.....	69
Grafikoni nr. 10. Perceptimi juaj, a luftohet në mënyre efikase krimi i organizuar në Kosovë.....	70
Grafikoni nr.11. perceptimi i opinionit mbi kolaborimin ne mes të krimit të organizuar kombëtar dhe ndërkombëtar.....	71
Grafikoni nr.12. Perceptimi juaj, mbi ekspansionin e krimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.....	71
Grafikoni nr. 13. perceptimet mbi ekspansionin e krimit të organizuar në Kosovë.....	72
Grafikoni nr.14. Sa është shteti i Kosovës i organizuar në luftimin e krimit të organizuar.....	72

Grafikoni nr.15. Sa janë të interesuar dhe organizuar institucionet e sigurisë dhe drejtësisë në Kosovë në luftimin e krimit të organizuar.....	73
Grafikoni nr. 16. Besimi juaj në institucionet e sigurisë dhe drejtësisë në luftimin e krimit të organizuar.....	73
Grafikoni nr.17. Perceptimi juaj mbi funksionimin e krimit të organizuar në Kosovë.....	74
Grafikoni nr.18. Perceptimi juaj, ndikimi i krimit të organizuar në sistemin politik të Kosovës.....	74
Grafikoni nr.19. Sipas mendimit tuaj, cila nga këto forma të krimit të organizuar është më e përhapur në Kosovë.....	75
Grafikoni nr.20. Perceptimi juaj, sa paraqet rrezik krimi i organizuar për të ardhmen e Kosovës.....	75
Grafikoni nr.21. Perceptimi juaj, mbi lidhjen e mundshëm të segmenteve të caktuara të politike(shtetërore) me krimin e organizuar në Kosovë.....	76

Falënderim

Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time të thellë ndaj të gjithë personave duke filluar nga stafi akademik i SEEU që në mënyra të ndryshme më kanë qëndruar pranë, më ndihmuar dhe inkurajuar në studimet e mia. Një falënderim të veçantë i shpreh mentorës të Tezës së Magjistraturës, *Prof. Asoc. Dr. Besa Arifi*, për mbështetje përzerv, për kurajo e besimi të plotë në punimin e tezës së magjistraturës, andaj, i shpreh mirënjohjen time të thellë për gatishmërinë e përzemërt dhe sugjerimet e vlefshme, për vlerësimin kritik të gjithë literaturës të përdorur dhe për të gjithë kontributin e dhënë në finalizimin me sukses të Tezës së Magjistraturës.

Një falënderim shkon për të gjithë stafin akademik dhe administrativ të *Universitetit të Evropës Juglindore*, i cili kontribuoj në formimin dhe ngritjen time akademike.

Gjithashtu një falënderim të veçantë dëshiroj t’jua dedikoj të gjithë *kolegëve*, të cilët më shumë se kushdo, kuptuan kënaqësinë time, prandaj i falënderoj ngrohtësisht, që se bashku ndamë mendimet, me ndoqën së bashku me ngulm pasionet dhe aspiratat, kolegë falënderit për impaktin pozitiv që patët tek unë. Por, sigurisht jo më pak, falënderoj familjen time për gjithë mbështetjen dhe përkrahjen përgjatë studimeve, si në aspektin moral, po ashtu edhe material.

Përzemërsisht, Andi Morina

Tetovë, Nëntor, 2021

Përmbledhje

Punimi i tezës së magjistraturës me titullin “Ekspansioni i krimit të organizuar nacional dhe transnacional, perceptimet, qëndrimet e opinionit publik të Kosovës”, do të ketë në fokus: perceptimet, qëndrimet e opinionit publik të Kosovës në lidhje me krimin e organizuar kombëtar dhe ndërkombëtar; pastaj trajtimin e nocionit dhe përkufizimin e krimit të organizuar; vështrimi historik i zhvillimit të krimit të organizuar; fushë-veprimtarinë kriminale të krimit të organizuar; format dhe llojet e krimit të organizuar; si dhe objektin dhe subjektin e krimit të organizuar etj. Teza e magjistraturës ndahet në dy pjesë: pjesën teorike në të cilën do të trajtohen aspektet teorike të krimit të organizuar, si dhe në pjesën empirike në të cilën do të diskutohen, analizohen të gjeturat nga studimi i zhvilluar nga një anketim i kryer me qytetarët e Republikës së Kosovës në lidhje me perceptimet, qëndrimet e opinionit të Kosovës në lidhje me krimin e organizuar kombëtar dhe ndërkombëtar, bashkëpunimi i krimit kombëtar më atë ndërkombëtar etj. Ky punim është i karakterit deskriptiv-përshkrues, korelativ, induktiv-deduktiv, i realizuar si një studim për të matur, testuar, vlerësuar perceptimet e qëndrimet e opinionit të vendit në lidhje me këtë problem global. Kampioni u përzgjedh përmes një metode selektive, duke marrë një kampion rastësor. Qëllimi themelor i tezës është që të evidentohen të dhënat teorike shkencore, aspekti analitik i krimit të organizuar si problem global, pastaj perceptimet, qëndrimet e opinionit në lidhje me aktivitetin dhe fushë veprimtarinë e krimit të organizuar. Në përpunimin e të dhënave do të përdorim metodologji të kombinuar, cilësore-sasiore, që synoi t’i japë përgjigje këtyre çështjeve themelore të ngritura në punimin e magjistraturës. Mostra është e përfaqësuar nga përbërja demografike e Kosovës. Duke përdorur mostrën e probabilitetit, margjina e gabimit të mostrës është 2.45%. Pas grumbullimit të dhënave të punimit gjetjet janë tabeluar të përpunuar në mënyre statistikore, të dhëna tabelare dhe ndër-tabelare formojnë bazën e hulumtimit. Të anketuarit janë pyetur në lidhje me perceptimet, qëndrimet e tyre në lidhje me krimin e organizuar kombëtar dhe ndërkombëtar. Anketimi është bazuar në një mostër prej 101 respondentëve, qytetar të Republikës së Kosovës. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se perceptimet e opinionit publik për krimin e organizuar kombëtar dhe ndërkombëtar ishte negativ, dënues ndaj veprimeve kriminale të grupeve të organizuara kriminale.

Fjalët kyqe: perceptimet, qëndrimet, krim, kriminal, krim i organizuar.

Përmbajtja:	
Falenderime.....	I
Përmbledhje.....	II
Abstract	III
Lista e Figurave	IV
Lista e Tabelave.....	V
Lista e Shkurtesave	VI
Përmbledhje.....	6
Përmbajtja.....	7
Hyrje	9
Kapitulli I	
Metodologjia e hulumtimit	11
1.1. Lënda e hulumtimit.....	13
1.2. Qëllimi i punimit të magjistraturës.....	13
1.3. Hipotezat.....	14
Kapitulli II	
Aspekti Teorik i punimit -Shqyrtimi i literaturës)	
2. Teoria e përmbajtjes.....	16
2.1. Teoritë e krimit të organizuar.....	17
2.2. Karakteristikat e organizatave kriminale.....	18
2.3. Përkufizimi i Krimit të Organizuar.....	19
2.4. Studimi i krimit të organizuar.....	21
2.5. Krimi i organizuar transnacional.....	22
2.6. Krimi i organizuar në Evrop dhe Ballkan	22
2.7. Krimi i organizuar shqiptar.....	26
2.7.1. Kuptimi dhe objekti i politikës kriminale.....	27
Kapitulli III	
3. Format e Krimi të Organizuar Transnacional.....	28
3.1. Krimi i Organizuar (Trafikimi i Drogës).....	29
3.2. Krimi i organizuar-Trafikimi i Armëve.....	31
3.3. Trafikimi me qenie njerëzore.....	33
3.4. Tregtia e paligjshme e organeve.....	38
3.5. Tregtia e paligjshme e pasurisë kulturore.....	41
3.6. Pastrimi i parave.....	43
3.6.1. Definicioni i pastrimit të parave.....	43
3.6.2. Lufta kundër pastrimit te parave.....	44
3.7. Lufta kundër pastrimit te parave.....	44
3.8. Task Force të Veprimit Financiar (FATF).....	45
3.8.1. Njësia e Inteligjencës Financiare e Kosovës.....	45
3.8.2. Format e Pastrimit te parave.....	45
3.8.3. Tre projektligje te Këshillit të Evropës.....	46
3.8.4. Metodatat e pastrimit te parave.....	46
3.8.5. Roli i institucioneve financiare në parandalimin e pastrimit të parave.....	47
3.9. Organizatat globale anti-krim.....	48

3.10. Rekomandime e Fondi Monetar në intensifikimin e luftës kundër pastrimit të parave.....	48
3.11. Mallra të falsifikuar dhe pirat.....	49
3.12. Tregtia e paligjshme e jetës së egër.....	50
3.13. Peshkimi i paligjshëm, i pa raportuar dhe i parregulluar (IUU).....	50
3.14. Kycje ilegale.....	50
3.15. Minierat e paligjshme.....	51
3.16. Vjedhja e naftës së papërpunuar.....	51
4. Kapitulli IV	
4. Krimi i organizuar në Kosove.....	52
4.1. Trafikimi me lëndë narkotike.....	52
4.2. Trafikimi me njerëz në Kosovë.....	57
4.3. Migrimi Ilegal	59
4.4. Kontrabanda me mallra	60
4.6. Korrupsioni dhe pastrimi i parave	62
4.7. Armët ilegale-kontrabanda me armë	63
Kapitulli V	
5. Perceptimet e opinionit publik të Kosovës.....	65
5.1. Perceptimet e Personave (njerëzve).....	65
5.2. Qëndrimet.....	67
Kapitulli VI	
Pjesa Empirike e Hulumtimit	
5. Analiza e rezultateve të hulumtimit.....	68
Kapitulli VII	
7. Rekomandimet e politikave.....	77
7.1. Juridiksionet e fshehtësisë.....	79
7.2. Faturimi i gabuar tregtar.....	81
7.3. Bashkëpunimi ndërinstytucional.....	82
Kapitulli VIII	
8.Përfundime dhe Rekomandime.....	84
8.1. Përfundime.....	84
8.2. Rekomandime.....	85
Kapitulli IX	
9. Konkluzionet.....	87
10. Referencat:.....	89

Hyrje

Krimi i organizuar në ditët e sotme është bërë pjesë e përditshmërisë së shoqërisë njerëzore, formimi i grupeve kriminale të cilët qëllim kryesor kanë veprimtarinë kriminale për përfitime në formë e mënyre të paligjshme, mjete financiare, kredo politike, shqetësime emocionale dhe lufte për pushteti kanë bërë që bota sot të jetë e sfiduar nga veprimtaria kriminale e krimit të organizuar transnacional. Termi “krim i organizuar” për herë të parë është përdorur në vitin 1896 në raportin vjetor të shoqatës për parandalimin e krimit në Nju Jork. Fillimisht, nocioni krim i organizuar nënkuptonte veprimtari të paligjshme ku përfshiheshin politikanë, zyrtarë policie, juristë dhe vjedhës profesionistë, veprimet e të cilëve ishin të organizuara e kriminale. Zanafilla e krimit të organizuar daton që nga viti 1800, për të vazhduar e intensifikuar në shekullin XIX dhe shekullin XX, gjatë viteve 1920/30 krimi i organizuar intensifikohet, për të marr një shkallë të kërcënimit kombëtar dhe ndërkombëtar, ndërsa gjatë vitet 1970/80, krimi i organizuar filloi të përhapet në shkallë transnacionale, sidomos pas rrënjës së Murit të Berlinit, dhe pas përfundimit të periudhës së luftës së ftohtë. Krimi i organizuar në fillim u shfaq në Itali dhe në Amerikë dhe më pas në vendet tjera. Për të folur për krimin e organizuar, fillimisht duhet, gjetur gjenezën e përdorimit të nocionit krim i organizuar. Sipas Letizia Pooli dhe Vander Beken, koncepti krim i organizuar është përdorur në fillim të vitit 1920, por për shkak të paqartësisë, pasaktësisë së definimit, nocion krim i organizuar është definuar në mënyrë të përgjithësuar në mënyrë eksplicite. Nocioni krim i organizuar për herë të parë mendohet se është përdorur në raportin vjetor të vitit 1896 për parandalimin e krimit nga shoqëria e Nju Jorkut (New York Society) i cili i referohej nëpunësit i cili operonte me veprimtari të kumorës, bigjozit dhe prostitucionit që ishin të mbrojtur nga zyrtarët publik. Ndërkaq në qarqet akademike filluan përpjekjet serioze për të përcaktuar dhe për të diskutuar nocionin krim, në kohën kur në masë të madhe zgjerohej veprimtaria e tregjeve të paligjshme në Amerikë. Nocioni i krimit të organizuar brenda periudhës kohore 95 vjeçare është përcaktuar në mes të dy koncepteve;

- a.) Si një grup i organizatave të qëndrueshme e të paligjshme në vetvete ose anëtarët e së cilës organizatë sistematikisht angazhoheshin në krim dhe
- b.) Si një vendosje e aktiviteteve të rënda penale, veçanërisht sigurimi i mallrave dhe shërbimeve të paligjshme, që kryesisht bëhej për përfitime monetare.

Disa nga teoricienët e hartimit të politikave dhe agjencive të zbatimit të ligjit, luhatshin në mes të dy koncepteve rivale mbi krimin e organizuar, por jo në mënyre të qartë. Ata i referoheshin organizatave kriminale të tilla si Mafia Siciliane dhe Amerikane, Cosa Nostra, Yakuzat Japoneze, Kartelës Kolumbiane dhe Drogës Meksikane, si dhe grupeve të tjera kriminale në mbarë botën, ku mendohej se kanë një strukturë hierarkike të qëndrueshme. Koncepti krim i organizuar është interpretuar më qartë në SHBA gjatë viteve 1970 i cili si nocion me pas është përhapur edhe në Evropë në vitet 1980. Politika, legjitimiteti dhe legaliteti i konceptit krim i organizuar ka ndryshuar skajshmërisht me kalimin e kohës, ngase veprimtaria e organizatave kriminale është intensifikuar, shumëfishuar. Deri në vitin 1980 veprimtaria e organizatave kriminale pos në SHBA dhe Itali nuk kanë paraqitur problem serioz. Ndërkaq pas vitit 1990 krimi i organizuar është bërë një nga problemet serioze në mbarë botën. Krimi i organizuar nënkupton organizimin kriminal, veprimtarinë kriminale të jashtëligjshme e cila veprimtari zhvillohet në një vend, shtet apo disa shtete. Krimi i organizuar është veprimtari kriminale e organizuar nga individ, grupe apo grupacione kombëtare e transnacionale.

Krimi i organizuar kombëtar, ka të bëjë me krimin e organizuar brenda një shteti, kombi, vendi, brenda kufirit të të njëjtit shtet. Krimi i organizuar ndër-kufitar kryhet dhe zhvillohet në mes të kufijve të dy e me shumë shteteve. Krimi i organizuar ndërshtetëror është krim i organizuar që zhvillohet në dy e më shumë shtete të ndryshme. Krimi i organizuar transnacional është krim i organizuar ndërkombëtar, shumëkombësh, që kryhet në shumë vende të botes, transnacional dhe transkontinental. Krimi i organizuar global është krim i organizuar shumëkombësh që kryhet në shumë shtete të botës. Veprimtaritë e organizatave kriminale janë të shumëllojshme, me veçori specifike, e struktura hierarkike. Për një periudhë të shkurtër kohore krimi i organizuar u bë fenomen transnacional. Pas vitit 1990 krimi i organizuar filloj të përhap pothuaj në mbarë botën, (edhe në në Kosovë e Shqipëri). Gjatë viteve të fundit në Kosovë vihet re një rritje e tregut të brendshëm(kontrabanda me mallra të ndryshme) së bashku me rritjen e numrit te përdoruesve(klientelës), andaj, është imediate që të shtohen jo vetëm masat shtypëse por edhe masat parandaluese.

Kapitulli I

1. Metodologjia e Hulumtimit

Punimi është realizuar nga kërkimi teoriko-empirik (induktiv) primar cilësor si dhe kërkimi (deduktiv) sekondar sasior. Hulumtimi është cilësor, në të cilin u anketuan 101 respondent nga Kosova, mbi çështjen; “Ekspansioni i krimit të organizuar nacional dhe transnacional, perceptimet, qëndrimet e opinionit publik të Kosovës”. Baza e vlerësimeve në këtë hulumtim përbën përmbledhjen e të dhënave mbi krimin e organizuar, statistika e të dhëna nga qeveritë e shteteve të ndryshme, raportet e organizatave joqeveritare, raportet e zbatuesve të ligjit si dhe vlerësimet e ekspertëve të tjerë. Në secilin kapitull trajtohen probleme të ndryshme në lidhje me krimin e paligjshëm, në kapituj të veçantë trajtohen të dhënat statistikore, metodologjia e evidentimit të burimit të të dhënave të përdorura për mallra të kontrabanduara, në hollësi janë përshkruar të dhënat e caktuara, si dhe tabelorët me të gjitha të dhënat dhe burimet e përdorura janë të parashikuara në secilën Shtojcë. Shumica e vlerësimeve që janë nxjerr vënë në pah raportet më shumë sesa një figurë, sepse ofrohen të dhënat që kanë të bëjnë me aktivitetet dhe veprimtarinë kriminale, të organizatave kriminale si veprimtari të fshehura. Në çdo pjesë të punimit jemi përqendruar në trajtimin e krimit të organizuar, duke eksploruar vlerën e tregut transnacional, dinamikën e tij, krimi ndikon në vendet në zhvillim. Krimi i organizuar transnacional në botë aktualisht është në një shkallë të lartë të ekspansionit të zhvillimit i cili cenon Integritetin Global në botën e zhvilluar, dhe asaj në zhvillim. Krimi i organizuar transnacional ka ndikime të konsiderueshme tek individë, komunitete, vende, shtete, kontinente dhe botë. Diskutimi mbi vlerën e krimit të organizuar qoftë për tregjet, qoftë për mallrat individuale, kryesisht bazohet në vlerësim. Pjesa më e madhe e njohurive për krimin e organizuar vijnë nga ndërhyrje dhe konfiskime, raste kur transparenca shpërthen natyrën klandestine të tregjeve. Ne vetëm mund të paraqesim hipoteza mbi veprimtarinë kriminale të krimit të organizuar nga raportet e siguruar nga inteligjencë të vlefshme që mund të informojnë politikën. Lufta në mes të krimit të organizuar dhe anti-krimit është intensifikuar gjatë viteve të fundit. Prandaj metodologjia e studimit, hulumtimit dhe burimet shpesh, përbëjnë një analizë kumulative që tregon dinamikën e organizatave kriminale, ndikimet e shkurtuara dhe lidhjen e krimit të organizuar me njëra tjetrën.

Në hulumtim janë përdorur këto metoda:

- a.) Metoda deskriptive(përshkruese), b.) Metoda krahasuese, c.) Metoda induktive-deduktive, d.) Modeli i studimit, teorik-empirik.

1.1. LËNDA E HULUMTIMIT

Tema e tezës së magjistraturës “Ekspansionit të krimit të organizuar kombëtar dhe ndërkombëtar, perceptimet, qëndrimet e opinionit publik të Kosovës” përbëhet nga këto komponent, aspekte të studimit;

- Vështrimi historik i fenomenit të krimit të organizuar, përkufizimi dhe shkollat;
- Studimi i ekspansionit të krimit të organizuar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Studimi i strukturës organizative të krimit të organizuar kombëtar dhe ndërkombëtar, shtjellimi i (llojeve) formave të krimit të organizuar (kosto e krimit të organizuar-dhe fitimi);
- Krimi i organizuar në nivel kombëtar;
- Perceptimet, qëndrimet e opinionit publik të Kosovës në lidhje me fenomenin e krimit të organizuar;
- Analiza dhe diskutimi i rezultateve të hulumtimit mbi perceptimet e opinionit publik mbi krimin e organizuar;
- Përfundimi dhe rekomandimet e tezës mbi krimin e organizuar.

1.2. Qëllimi i punimit të Magjistraturës

Qëllimi i tezës të magjistraturës është që të trajtojë në mënyrë analitike njohuritë nga fusha e krimit të organizuar, studimi do të jetë analitik, sistematik dhe shkencor në të cilin në mënyrë të detajuar do të trajtohet fenomenin i krimit të organizuar, specifikat të cilat nxisin ekspansionin dhe evoluimin e krimit të organizuar në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar. Synojmë që përmes këtij hulumtimi, studimi të ofrojë sugjerime dhe rekomandime të cilat rrjedhin logjikisht nga analiza e strategjive për një luftë sa më efikase, efektive të krimit të organizuar. Në studimin e zhvilluar do të ofrohen fakte, njohuri teorike dhe empirike sa më të plota mbi veprimtaritë kriminale të krimit të organizuar, do të ofrojmë fakte mbi fushë veprimtarinë e krimit të organizuar, llojet e krimit të organizuar, perceptimet dhe qëndrimet e opinionit publik të Kosovës në lidhje me fenomenin e krimit të organizuar.

Qëllimet tjera;

- 1. Analiza shkencore mbi ekspansionin e krimit të organizuar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, shkaqet;
- 2. Analiza shkencore e strukturës organizative së krimit të organizuar kombëtar dhe ndërkombëtar;
- 3. Analiza e studimit të formave të krimit të organizuar, dëmet (kosto)ekonomike që shkakton krimi i organizuar;
- 4. Analiza e manifestimit, funksionimit të Krimit të organizuar në nivel kombëtar në Kosovë, strategjitë kombëtare dhe ndërkombëtare të luftimit të krimit të organizuar;
- 5. Analiza e bashkëveprimeve anti-krim në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar;
- 6. Analizimi i strategjive anti-krim, më qëllim të identifikimit, parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar ;
- 7. Analiza e perceptimet, qëndrimet e opinionit publik të Kosovës në lidhje me fenomenin e krimit të organizuar;
- 8. Analiza dhe diskutimi i rezultateve të hulumtimit.

1.3. Hipotezat

Hipoteza e përgjithshme: “Ekspansioni i krimit të organizuar është një nga problemet më të rënda të botës bashkëkohore, i cili lindi, u zhvillua si produkt i hapjes së kufinjëve të botës, globalizmit, zhvillimit tekniko-teknologjik, liberalizmit të lëvizjes së mallrave dhe idesë, tregtisë së lirë, të cilat u keqpërdoren nga persona e grupe të organizuara të inkriminuara, qëllimi primar i të cilëve është pasurimi pa mund e ndjersë”.

Në bazë të qëllimit të studimit shtrojm hipotezat ndihmëse, të cilat janë:

- **Hipoteza 1:** “Nuk ekzistojnë dallime esenciale në perceptimet e opinionit publik në aspektin e lidhjes së krimit të organizuar, me disa nga eksponentët, segmente të politikës dhe para politikës në nivel kombëtarë më atë ndërkombëtarë”;
- **Hipoteza 2:** “Nuk ekzistojnë ndryshime esenciale në mendimet, bindjet mbi krimin e organizuar si një nga sfidat dhe problemet më të rënda për shtetet dhe shoqërinë bashkëkohore si në nivelin kombëtar ashtu dhe në nivelin ndërkombëtar”;

- *Hipoteza 3*: “Nuk ekzistojnë ndryshime esenciale në mendimet se në shumë shtete të botës krimi i organizuar është i lidhur me segmentet e shtetit, ekziston një aleancë e heshtur për përfitime personale e grupore”;
- *Hipoteza 4*: “Nuk ekzistojnë dallime substanciale në mes të perceptimeve e opinionit publik mbi veprimtarinë kriminale të krimit të organizuar ndërkombëtar dhe kombëtar”;

Kapitullim II

Shqyrtimi i literaturës

2. Teori a e përmbajtjes

Teoria e përmbajtjes lindi në institutin për Kërkime të Konfliktëve dhe të Paqes, në Kopenhaga si shkollë e re dhe më e avancuar në raport me të vjetrën tradicionale,¹ shkolla e studimeve të sigurisë e Kopenhagës është një shkollë e mendimit akademik, origjinën e ka në librin e teorive të marrëdhënieve ndërkombëtare të autorit Barry Busan, me titull “Njerëzit, shtete dhe frika” dhe në librin “Problemi i sigurisë kombëtare në marrëdhëniet ndërkombëtare”, botuar në vitin 1983, (botimi i parë) dhe ribotimi në vitin 2003, si dhe në idetë e pikëpamjet e përfaqësuesve me të shquar; (Berry Busan & Ole Waiver dhe Jep de Uald-it), të cilët botuan librin me titull, ”Siguria një kuadër i ri analize”(Security: A new Framework for Analysis) dhe kjo qasje u bë e njohur si shkolla e Kopenhagës, (Bill Mc Sweeny, 1996). Shkolla e Kopenhagës zhvilloi bazën teorike të bazuar në tri ide themelore; 1. Sektorin e sigurisë; 2. Komplekset rajonale të sigurisë dhe 3. Sigurizimin.² Duke analizuar me kujdes këto tri teori dhe idetë të kësaj shkolle, rezultoi se është bërë zgjerimi dhe thellimi i studimeve për sigurinë, edhe në problemet jo ushtarake, duke vërtetuar faktin që nuk është vetëm shteti ai që mund të jetë objekt i kërcënimit të sigurisë, por edhe të tjerët. Fokusi i studimit të shkollës së Kopenhagës ishte në këto fusha;

- a.) Në sigurinë ushtarake;
- b.) Sigurinë ekonomike;
- c.) Sigurinë Politike;
- d.) Sigurinë shoqërore dhe në
- e.) Sigurinë e mjedisit jetësor.³

Ndërkohë në lidhje me kompleksitetin rajonal të sigurisë, nivelet e kërcënimeve të sigurisë përveç shtetit, përfshijnë edhe shoqërinë dhe individin.⁴ Barry Buzan Ole Waever dhe Jap de Wilde i dhanë një trajtë të re analizës së sigurisë, nëpërmjet se cilës e zgjeruan konceptin

¹ . C. ALAN, “CONTEMPORARY SECURITY STUDIES”, 2010, FAQ. 474.)

² . <http://www.unodc.org/document/treaties/UNTOC/Publications/TOC%20Convention/TOCebook-e.pdf>.

³ . B. BARRY, W. OLE, AND W.JAAP, “A NEW FRAMEWORK FOR ANALYSIS”

⁴ . B. Barry, “Security Analysis”, Conceptual Apparatus, 2003.

kompleks të sigurisë dhe i dhanë rëndësi të veçantë nivelit rajonal të sigurisë. Kjo shkollë i përfshin studimet e sigurisë së karakterit jo shtetëror (shoqëritë dhe mjedisin). Kjo konsiderohej si një qasje pozitiviste dhe tradicionale ndaj sigurisë ata ishin pionier të lëvizjes për ndryshimin e qasjeve tradicionale të sigurisë.” Koncepti, respektivisht nocioni “sigurizim” do të thotë, kur një çështje paraqitet si kërcënim, ajo bëhet problem i sigurisë. Përfaqësuesit e shkollës së Kopenhagës, ndryshe nga teoricientët e tjerë të teorisë së sigurisë, sigurinë si koncept në kuptimin e ngushtë e kuptojnë si sigurim të ekzistencës, duke përcaktuar dy komponentë; 1.) Sovranitetin që është parakusht i ekzistencës së shtetit, por edhe si kriter i sigurisë së shtetit, dhe 2.) Identitetin shoqëror si kriter më i lartë i sigurisë së shoqërisë ose sigurisë shoqërore, përfaqësuesit e shkollës së Kopenhagës rëndësi të veçantë i japin konceptit të sigurisë shoqëri, sepse sigurimi nuk mund të studiohet dhe kuptohet nëse nuk vlerësohet siguria si produkt shoqëror, ngase “krimi vepron për gjatë vijave nacionale, klasave, shtresave, shteteve e kontinenteve në tërë botën.”⁵ Kopenhagistët sugjerojnë se dobësitë e shtetit konfirmohen edhe me dallimet e mëdha ndërmjet interesave të vet shtetit dhe grupeve etnike, politike ose shoqërore. Andaj, gjendja e qëndrueshme e sigurisë sipas tyre nënkupton gjendjen që minimizon dhe parandalon çdo lloj rreziku të integritetit territorial, konfliktet etnike, krimin e organizuar dhe korrupsionin. Sipas idesë së shkollës së Kopenhagës vetëm shteti është aktori që mund të garantoj sigurinë.

2.1. Teoritë e krimit të organizuar

Teoritë që studiojnë shkaqet e paraqitjes së krimit të organizuar ndahen në:

- a.) Teoria e parandalimit të përgjithshëm;
- b.) Teoria funksionale;
- c.) Teoria organizative e krimit të organizuar;
- d.) Teoria e papërshtatshmërisë;
- e.) Teoria e nën-kulturës dhe anti-kulturës, dhe parandalimit të kriminalitetit;
- ë.) Teoria e lidhjeve konspirative;
- f.) Teoria e çorganizimit shoqëror;

⁵. P. Eugen & P. Jani, “Kriminalogji Penalogji”, 2000, faq, 10

i.) Teoria e zgjedhjes racionale dhe

j.) Teoria e anemisë.

2.2. Karakteristikat e organizatave kriminale

Veprimtaritë kriminale ngërthejnë në vete karakteristika politike, ekonomike, juridike, shoqërore, pastaj teknika të veçanta të veprimtarisë, mjete dhe instrumente të ndryshme të veprimit kriminal, karakteristikat tjera janë shtrirja gjeografike e shteteve si dhe marrëdhëniet ndërmjet organizatave, karakteristikat kulturore, arsimore dhe nivelin psikologjik. Krimi i organizuar paraqet kërcënim, rrezik për shoqërinë, rendin dhe qetësinë publike, shoqërinë dhe normalitetin shoqëror, pavarësinë, integritetin dhe funksionimin demokratik, të shtetit ligjor si dhe sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare. Karakteristikat e krimit të organizuar dallojnë nga format e organizimit të grupit, anëtarëve dhe rrjetit. Sipas Michael D.Lyman .Y dhe Garry W. Potter, grupet e krimit të organizuar kanë këto karakteristika:

1. Janë jo ideologjike(nuk kanë qëllim politik, kanë qëllime të përfitimit material);
2. Janë hierarkike (kanë zingjir të udhëheqjes) janë të strukturuar me hierarki vertikale dhe me udhëheqje absolute të bosit;
3. Kanë anëtarësi të kufizuar dhe të veçanta (anëtarësimi është jo i lehtë, bazohet në racë, etni, faretisni, shoqëri, familje etj);
4. Janë të përhershme, d.m.th zgjasin edhe pas vdekjes së anëtarit të grupit;
5. Përdorin dhunën, kanosjen, dhe korrupsionin;
6. Demonstrjnë ndarje specifike të punëve, veprimeve kriminale(planifikim në detaje);
7. Janë monopoliste, ato krijojnë monopol p.sh. në bixhoz, prostitucion, droge etj;
8. Janë të udhëhequra nga normat dhe rregullat e qarta që kanë të bëjnë me organizimin e brendshëm, sjelljen e anëtarëve, etj.;
9. Sekreti i aktivitetit dhe i veprimit të organizatës;
10. Mos tolerimi i tradhtisë ndaj udhëheqjes dhe anëtarëve të organizatës;
11. Fushe veprimtaria e organizatës në përmasa ndërkombëtare.⁶

Studiues tjerë veçojnë karakteristika tjera për krimin e organizuar; siç janë: Ekzistimi i lidhjeve ndërmjet organizatave kriminale me shtetin dhe organet e tij. Aktiviteti i organizatave,

⁶ . MICHAEL. L. D. AND POTTERW. W. P. “ORGANIZED CRIME”, ISBN-13: 978-0133571738

grupeve kriminale zakonisht përqendrohet në dhunë fizike dhe psikike, kërcënime, shantazhe, mit-dhënia, lidhje me organet e sigurisë, policinë, prokurorinë, gjykatat si dhe me organet e tjera shtetërore. Krimi i organizuar aktualisht paraqet si një nga sfidat më të rënda të shoqërisë bashkëkohore si në fushën juridiko-ligjore, shoqërore e psikologjike, politike, ekonomike, kombëtare e ndërkombëtare.

2.3. Përkufizimi i Krimit të Organizuar

Në lidhje me përkufizimin e krimit të organizuar, do përqendrohemi në përkufizimet që kanë dhënë organizatat ndërkombëtare. Sipas nenit 2 të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional, të nënshkruar në dhjetor të 2000-ës, me nocionin krim të organizuar kuptojmë çdo grup i strukturuar i përbërë nga tre ose më shumë individ, i cili ekziston për një periudhë të caktuar kohore dhe vepron në përputhje me qëllimin e kryerjes se një ose më shumë krimeve ose shkeljeve për të garantuar, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë përfitim financiar, ose të një natyre tjetër materiale.⁷ Ndërkaq, Agjencia Amerikane për zbatimin e ligjit jep këtë përkufizim, “Krimi i organizuar përbën një aktivitet kriminal të dënueshëm, të vazhdueshëm e vetëveprues, duke pasur një strukturë të organizuar, të ushqyer nga frika dhe korrupsioni dhe të motivuar nga etja për fitim.⁸ Sipas FBI krimi i organizuar është “Një marrëveshje të fshehtë të bashkëpunimi që vazhdon dhe përsëritet, që mbahet nga frika dhe korrupsioni dhe motivohet nga përfitimi ekonomik”⁹. Sipas OKB-se krimi i organizuar është;” Veprimtari kriminale me përmasa të mëdha të kryer nga grupe personash, të organizuar apo pak të organizuar, për pasurimin e anëtarëve në dëm të komunitetit dhe qytetareve. Në shumicën e rasteve realizohet nëpërmjet shkeljes flagrante të ligjit ku janë të përfshira krimet kundër personit dhe shpesh në bashkëpunim me korrupsionin politik”¹⁰ (United Nations, OKB-1975, -80). Sipas Këshillit të Evropës Krimi i organizuar: “Është veprimtari e fshehtë e bërë nga grupet të organizuara më shumë se tre persona, të veprimit për një kohë të gjatë me synimin e kryerjes së krimeve të rënda nëpërmjet veprimit të përbashkët dhe duke përdorur frikësimin, dhunën, korrupsionin ose mjetet e tjera për të siguruar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për përfitim financiar ose të një lloji tjetër material”¹¹.

⁷ . Konventa e Asamblesë së Përgjithshme të OKB kundër krimit të organizuar (Palermo 2000), neni 2, ratifikuar me ligjin nr. 8920 date 11.07.2002.

⁸ . Kërcënimet e krimit të organizuar ndërkombëtar “Raporti i Këshillit të Sigurimit Kombëtar të SHBA, Uashington, 2002, faq. 6.

⁹ . FBI

¹⁰ . United Nations, OKB-1975, 80

¹¹ . Concul of Europa, 2002,faq. 6- GUIDE ON ARTICLE 6 RIGHT TO A FAIR TRIAL (criminal limb)

Sipas Kodit Penal të Kosovës, Krimi i Organizuar klasifikohet në Nenin 283 “ Kushdo që me dashje dhe me dijeni qoftë të qëllimit dhe veprimtarisë së përgjithshme të grupit kriminal të organizuar ose qëllimit të grupit për të kryer një apo më shumë vepra penale të cilat janë të dënueshme me burgim.....”¹² Këshilli i Evropës në rekomandimin e tij (2001), miratoi një përkufizim të ngjashëm të grupit të krimit të organizuar, pa e reduktuar fushën e tij të veprimit tek veprat e ndaluara ndërkombëtare. (UNTOC-Konventa mbi Krimin e Organizuar Ndërkufitar i Kombeve të Bashkuara). Kjo Konventë, ka hyrë në fuqi në shtator të vitit 2003 dhe zbatohet për krimin e organizuar, korrupsionin, pastrimin e parave dhe pengimin e drejtësisë, por me kusht që vepra penale të ketë natyrë ndërkombëtare dhe të përfshijë një grup të organizuar kriminal, sipas përkufizimit të dhënë në konventë. Në nenin 2 të kësaj Konvente jepen përkufizimet e terminologjisë kryesore që e karakterizojnë këtë fushë:

- a.) *Grupi i organizuar kriminal*, nënkupton një grup të strukturuar, i cili ka ekzistuar për një periudhë kohe të caktuar, i përbërë nga një ose më shumë persona, të cilët veprojnë në harmoni me njëri-tjetrin, me qëllim që të kryejnë një ose më shumë krime, ose vepra penale serioze, të përcaktuara si të tilla, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, me qëllim që të sigurojnë, në mënyrë direkte ose indirekte, përfitime financiare ose materiale¹³.
- b.) *Krimi i rëndë*, nënkupton atë akt që përbën vepër penale të ndëshkueshme me dënim maksimal heqje lirie të paktën katër vjet ose me dënim më të rëndë.¹⁴
- c.) *Grup i strukturuar*, nënkupton një grup që nuk krijohet rastësisht për kryerjen e menjëhershme të një vepre penale dhe që nuk nevojitet të ketë të përcaktuar rolet e anëtarëve të tij, vazhdimësinë e anëtarësimit në të, ose të ketë një strukturë të zhvilluar. Përgjigjet që iu dhanë pyetësorit tregojnë se të gjitha zonat e projektit e kanë inkuadruar një përkufizim të tillë të krimit të organizuar dhe të grupit të krimit të organizuar në legjislativet e tyre penale.¹⁵

Struktura e organizatave kriminale mund të jetë strukturë e ngurtë, e zhvilluar, konglomerat, grup bërthamë apo rrjet. Kjo ndarje mund të ndryshojë sepse zhvillimi i organizatave paraqitet i paqëndrueshëm dhe shumë fleksibil, megjithatë kjo jep një paraqitje të


¹² . Kodi Penal i Kosovës-KODI NR. 04/L-082, faqe, 105

¹³ . United Nations, “UN Convention against Transnational Organized Crime and the Protocols Thereto”, entry into force: 29 September 2003, New York: UNODC Publications, 2004, f. 5-6.

¹⁴ . United Nations, “UN Convention against Transnational Organized Crime and the Protocols Thereto”, entry into force: 29 September 2003, New York: UNODC Publications, 2004, f. 6-7.


¹⁵ . United Nations, “UN Convention against Transnational Organized Crime and the Protocols Thereto”, entry into force: 29 September 2003, New York: UNODC Publications, 2004, f. 7-8.

përgjithshme. Për paraqitjen grafike të këtyre strukturave i kemi referuar punimit të Grupet e organizuara kriminale dhe profilet nga Tihana Tucakoviç. Këto struktura paraqiten si më poshtë:



Strukturë e ngurtë

Strukturë e zhvilluar



Strukturë Konglomerat

Strukturë bërthamë

Fig.1. Strukturim i grupeve të krimit të organizuar sipas Tucakoviç.¹⁶

2.4. Studimi i krimit të organizuar

Studimet e para mbi krimin e organizuar filluan nga qeveria Amerikane në mes viteve 1929/31 nën kujdesin e Komisionit Kombëtar mbi ligjin, vëzhgimin dhe zbatimin të kryesuar nga Georg Wickersham. Nga viti 1940 e tutje fokusi i studimit të krimit të organizuar ishte krimi i karrierës dhe të huajt, të cilët gjoja përbënin mirë strukturim dhe organizata të fuqishme kriminale që përfaqësonin një kërcënim për integritetin e shoqërisë Amerikane. Krimi i organizuar kombëtar dhe ai ndërkombëtar kërcënon seriozisht sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare.

¹⁶ . *Burimi*: Tucakoviç, T, “Organized criminals group and profiles”, Zagreb: University of Zagreb - Faculty of Law, f. 40-56.

2.5. Krimi i organizuar transnacional

Krimi i organizuar është një nga sfidat me kritike të botës demokratike, si dhe i shoqërive në tranzicion. Për të luftuar krimin e organizuar kërkohet një strategji gjithëpërfshirëse globale, e cila përfshin zbatimin e ligjit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, funksionimi i zgjeruar i Inteligjencës, bashkëpunimi ndërshtetëror, duke përfshirë ndryshimin e qëndrimeve kulturore ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionin në shoqëritë bashkëkohore. Krimi i organizuar përbën pjesën më të errët të globalizmit, i cili si proces botëror po shfrytëzohet shumë nga krimi dhe kriminelet. Krimi po lulëzon në vendet e përfshira në konflikte e luftë, në vendet në tranzicion, në vendet e varfra, të pazhvilluara, në vendet ku qeveria është e korruptuar e me kapacitet të ulët. Kushtet gjeografike janë faktor i rëndësishëm në intensifikimin e krimit të organizuar, “malet e thyera” dhe “një vijë bregdetare e gjatë” sikur gadishulli Italian dhe Sicili. Vija bregdetare e Italisë është jashtëzakonisht e gjatë, një mundësi e dukshme për krimin e organizuar, trafikim e kontrabandë, kjo nuk është për tu habitur sepse një aktivitet i madh i krimit të organizuar janë njerëz kontrabandistë.¹⁷ Shqipëria, në fund të fundit, duket vetëm nëpërmjet detit Adriatik nga Italinë juglindore, atdheu i Sacra Corona Unita.” Në shtetet e dobëta ose shtetet e dështuara, apo vendet që kanë institucione të brishta, politika të paqëndrueshme, shtetet totalitare, me demokraci në zhvillim, me ekonomi të dobët, me varfëri e papunësi, mungesë investimesh, drejtues shteti dhe politikanë të lartë të korruptuar, janë pre e krimit të organizuar.

2.6. Krimi i organizuar në Evropë dhe Ballkan

Krimi i organizuar dhe kontrolli i disa shteteve nga organizata mafioze është kthyer në shqetësimin kryesor në arenën ndërkombëtare, veçanërisht për Bashkimin Evropian, i cili në kufinj të tij të jashtëm përballet me rrugët kryesore të trafikimeve nga Lindja drejt Perëndimit. Ballkani Perëndimor dhe rrugëkalimet e tij janë quajtur shpesh në literaturë si “dera e pasme” e BE-së, shtetet e Ballkanit juglindor, Maqedonia, Serbia, Kosova, Mali i zi, Shqipëria paraqesin “rezikshmërinë” që paraqitet si pasojë e pozicionit të saj gjeografik dhe shpesh është ndeshur me retorika të forta për përpjekjet në luftën kundër krimit të organizuar dhe sigurimit të vijës kufitare. Një nga problemet më të prehtë është veprimtaria e krimit të organizuar ndërkombëtar në sferën e ekonomisë dhe terrorizmi, të cilët i kundërvihen dhe dëmtojnë rëndë sigurinë dhe ekonominë kombëtare, duke e kriminalizuar atë në sektorë dhe drejtime të

¹⁷ . Dennis M. P. Mc. Corthy, *Sacra Corona Unita, 1997,-78-79.*

caktuara.¹⁸ Disa nga pasojat e veprimtarisë kriminale në këtë kontekst janë: a.) dëmtimi i institucioneve shtetërore dhe funksionimi i tyre, duke krijuar anarki dhe duke ulur efektivitetin e veprimtarisë; b.) rrëmbimi i pushtetit, nëpërmjet ndërhyrjeve në organet legjislative, ekzekutive dhe të drejtësisë, duke ndikuar në proceset e vendimmarrjes; c.) krijimi i lobeve e klaneve që mbrojnë interesat e organizatës ose grupit kriminal; d.) dëmtimi ekonomik e financiar nëpërmjet qarkullimit të vlerave financiare e materiale në rrugë të kundërligjshme; minimi dhe dëmtimi i besimit të opinionit publik për qeverisjen në të dy nivelet; e.) zhvlerësimi i vlerave morale dhe krijimi i modeleve nga bota e krimit me vjedhje, dhunë, mashtrim, etj.¹⁹ Në rajonin e Ballkanit, krimi i organizuar është zhvilluar në varësi të zhvillimeve politike, shoqërore, ekonomike, kriminaliteti ka kapluar rajoni dhe vendet e veçanta në përgjithësi, diku më shumë diku më pak. Pas zhvillimeve në ish kampin e shteteve të Evropës lindore, në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Bullgari, Rumani, etj, krimi i organizuar u zhvillua me shpejtësi si për nga masa, vëllimi, duke marr formë të reja specifike. Format më të përhapura të krimit të organizuar në rajonin e Ballkanit juglindor janë: krimi me natyrë politike kundër popullatës në ish Jugosllavi; vrasjet e politikanëve, figurave publike, biznesmenëve; trafikimi i qenieve njerëzore drejt shteteve Perëndimore, veçanërisht i femrave për zhvillimin e prostitucionit; trafikimi i mallrave të ndryshme si cigareve, karburanteve, kafesë e artikujve të tjerë me qëllim fitimi; trafikimi i drogës dhe armëve drejt tregut të Evropës Perëndimore dhe vendeve në konflikte të ndryshme; krimi në fushën ekonomike dhe financiare në drejtim të privatizimeve të objekteve të ndryshme, pastrimit të parasë etj. Për rajonin e Ballkanit vlen të përmendet zhvillimi i krimeve kundër njerëzimit dhe krimit të organizuar politik në ish Republikat Jugosllave, veçanërisht në Bosnjë, Kroaci dhe në Kosovë, ku regjimi kreu krime të rënda kundër njerëzimit me dëbime e vrasje masive të popullsisë.²⁰

Krimi i organizuar në Serbi; Krimi i organizuar serb, janë organizata të ndryshme kriminale me bazë në Serbi ose të përbërë nga serbë etnikë në ish-Jugosllavi dhe diasporë serbe. Organizatat janë të përfshira kryesisht në kontrabandë, trafik armësh, trafik droge, raketa mbrojtëse dhe bixhoz të paligjshëm. Kriminelët serbë janë rekrutuar nga forcat e sigurimit të shtetit, një shembull i dukshëm është Milorad "Legija" Ulemek, një komandant i Tigrave të Arkanit, i cili u riemërtua pas luftës si JSO (Beretat e Kuqe). Grupet etnike serbe të krimit të

¹⁸ . Gjonça. L, “Pastrimi i produkteve të veprës penale dhe krimi i organizuar”, *Revista Shkencore Jusitnai I*, viti i parë i botimit, nr. 1, Tiranë: dhjetor 2009, f. 25.

¹⁹ . Hysi. V, “Kriminologjia”, Tiranë: Kristalina-KH, 2005.

²⁰ . Shala. XH, “Siguria kombëtare dhe sfidat e integritetit”, Tiranë: Qendra Shqiptare e Studimeve për Sigurinë Kombëtare, 2003.

organizuar janë të organizuar në mënyrë horizontale; anëtarët e rangut më të lartë nuk koordinohen domosdoshmërisht nga ndonjë udhëheqës.²¹ Grupet tjera kriminale serbe janë; Ljuba Zemunac, ishte i njohur si "Kumbari" i mafies serbe, "Joca Amsterdam" u bë e njohur si "Mbreti i Kokainës". Ai punoi për "Duja" Bećirović si një nëpunës dhe më vonë jetoi në Bullgari, ku ai kontrabandoi me sukses drogë deri në arrestimin e tij në 2002. Pas kthimit në Serbi, ai mori kompanitë me forcë, duke përdorur klanin Surčin,(një nga tre atëherë "klanet" më të fuqishme të Beogradit). Zheljko "Arkan" Ražnatović ishte një grabitës i suksesshëm i bankave në Evropën Perëndimore në vitet 1970. Ai kishte dënime dhe urdhër në Belgjikë, Hollandë, Suedi, Gjermani, Austri, Zvicër dhe Itali. Sidoqoftë, ai arriti të arratisesh nga disa burgje dhe më pas bëri lidhje me disa kriminelë të njohur nga Jugosllavia. Në vitet 1980 ai u kthye në Serbi ku u përfshi me biznese të paligjshme dhe udhëhoqi grupin e mbështetësve të Yllit të Kuq të Beogradit "Delije Sever" ("Ultras").²² Përparimi i vërtetë për organizatat kriminale në Serbi ndodhi në fillim të viteve 1990, kur Luftërat Jugosllave shpërthyen në fillim në Kroaci dhe më pas në Bosnjë e Kosovë. Në vitin 1992, anëtarët e bandës "Peca" Dušan Spasojević i cili u bë kreu i klanit Zemun. Arkani ishte themeluesi dhe udhëheqësi i Gardës Vullnetare Serbe (Tigrat e Arkanit), një njësi paraushtarake serbe që luftoi gjatë Luftërave në ish Jugosllavi. Arkani më vonë themeloi Partinë e Unitetit Serb në 1993. Në kohën kur u kthye në Serbi, ai ishte bërë anëtar më i fuqishëm i Mafisë Serbe.²³ Ivan Stambolić, ish-presidenti serb u rrëmbye në Beograd, pak para zgjedhjeve federale se ai mund të përfshihej si një kandidat për President të RFJ-së, dhe që atëherë ai u zhduk pa lënë gjurmë. Në Serbi krimi i organizuar u nxit dhe u realizua nga pushteti fashist i Slobodan Millosheviqit, duke zhdukur figura politike e publike, shembull tipik i krimit politik është vrasja e kryeministrit Zoran Gjingjiç.

Krimi i organizuar **në Malin e Zi**; Mafia malazeze u referohet organizatave të ndryshme kriminale me bazë në Mal të Zi ose të përbërë nga malazezë. Konsiderohet se në Mal të Zi veprojnë afro 3700 kriminelë të organizuar të dokumentuar që veprojnë brenda Malit të Zi dhe jashtë vendit, bandat malazeze janë aktive në të gjithë Evropën-veçanërisht Serbia. Bandat tentojnë të specializohen në kontrabandën e cigareve, narkotikëve dhe trafikimin e armëve. Policia malazeze sapo ka filluar dokumentimin dhe ndërmarrjen e veprimeve kundër

²¹.http://www.etc.graz.at/cms/fileadmin/user_upload/humsec/Journal/Stojarova_Organized_Crime_in_the_Western_Balkans.pdf

²² . <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/605266.stm>

²³ . <https://www.nytimes.com/2003/05/05/world/belgrade-journal-for-partying-mobsters-the-morning-after-prison.html>

shumë bandave kriminale brenda Malit të Zi, duke zbuluar një rrjet të gjerë të karteleve dhe grupeve të fuqishme që luajnë një rol qendror në krimin e organizuar brenda Ballkanit.²⁴ Karteli i Tivarit, Organizata përfshihet kryesisht në kontrabandë, trafik armësh, raketa mbrojtëse dhe lojëra të fatit të paligjshëm. Grupi është i organizuar në mënyrë horizontale dhe anëtarët e rangut më të lartë nuk koordinohen domosdoshmërisht nga ndonjë udhëheqës edhe pse kohët e fundit mafia e Tivarit filloi rregullimin e hierarkisë së saj vertikale duke e bërë organizatën shumë më të fortë. Organizata ka një reputacion lokal të ketë lidhje me burra të korruptuar të rangut të lartë në Herceg Novi, Tivat, Kotor, Budva dhe Njësitë Rajonale të Policisë së Ulqinit.²⁵

Në Maqedoni, Krimi i organizuar në Maqedoninë e Veriut, format më të përhapura të krimit të organizuar janë korrupsioni, trafiku i qenieve njerëzore, i lëndëve narkotike, i makinave, prodhimi i pijeve të ndryshme me marka të falsifikuara, etj. Pozicioni i këtij vendi do vazhdojë të lakmohet dhe përdoret edhe në të ardhmen për transitin e drogës nga Lindja, të femrave për prostitucion në Perëndim, të mallrave të ndryshme tregtare, etj.

Në Bullgari; Grupet bullgare të krimit të organizuar janë të përfshirë në një gamë të gjerë aktivitesh, përfshirë trafikimin e drogës, kontrabandën e cigareve, trafikimin e qenieve njerëzore, prostitucionin, trafikimin e antikave të paligjshme, zhvatjen (shpesh nën mbulesën e kompanive të dukshme të sigurimit dhe sigurimeve), dallavere, krime të ndryshme financiare, makinë vjedhja dhe tregtia e armëve. Ata duket se kanë lidhje të mira me mafien ruse, Solntsevskaya Bratva, mafien ukrainase, mafien siciliane, kartelin Sinaloa, mafien shqiptare, mafien serbe dhe italianin Cosa Nostra. Grupet e krimit të organizuar në Bullgari merren me importin e kokainës dhe shumë mijëra doza ekstaze në Shtetet e Bashkuara. Aktualisht, Bullgaria ka probleme të shumta me trafiket, privatizimet, trafikun e drogës e lëndëve të tjera narkotike, korrupsionin e lartë, etj. Vetëm në vitet e fundit, në Bullgari janë kryer rreth 100 vrasje të tipit mafioz të figurave të biznesit dhe politikës, nga të cilat organet e drejtësisë nuk kanë mundur të zbardhin asnjë. Aktualisht në këtë vend është shtrirë shumë krimi i organizuar dhe korrupsioni, ka rënë ndjeshëm besimi i komunitetit, prandaj BE ka bllokuar ndihmat me kusht që të ndryshojë gjendja.

²⁴ . <http://www.novinar.de/2007/05/17/veliki-pljackasi-i-dileri-evrope.html>

²⁵ . <https://www.kurir.rs/region/crna-gora/2489133/kotorski-komandir-priznao-da-je-clan-narko-klana-vodama-dojavljiavo-kada-da-beze-od-policije>

Në **Greqi**; Krimi i organizuar Grek në përgjithësi vepron kryesisht në Greqi. Për organizatat kriminale greko-amerikane ndonjëherë të njohura si "Mafia Greke", familjen kriminale të Mobilave Grek të Filadelfias dhe Velentzas. Grupet e krimit të organizuar Grek janë të shtrirë në Greqi, Shqipëri, Holandë, Itali, Kazakistan, Mbretëri e Bashkuar, Gjermani, Bullgari, Argjentinë, Shtetet e Bashkuara, Australi, Kanada, Kinë, Republika e Irlandës, Qipro, Afrika e Jugut dhe pjesë të tjera të Afrikës. Fushat e aktiviteteve të grupeve kriminale Greke janë: trafikimi i drogës, trafiku i armëve, atentat, sulm, mashtrim bankar, shantazh, ryshfet, vrasje me kontratë, zhvatje, mashtrim, hyrje, kumar i paligjshëm, mashtrim sigurimesh, rrëmbime, pastrim parash, korrupsion policor, korrupsion politik, dallavere, evazion fiskal, frikësim i dëshmitarit, manipulim i dëshmitarit. Grupet mafioze në qytetet më të mëdha janë veçanërisht të përfshira në dallavere, kontrabandë të paligjshme të naftës, pastrim parash, trafik të armëve dhe drogës si dhe vrasje.²⁶ Grupet kriminale në territorin grek gjithashtu kanë përfituar nga aktivitetet e zyrtarëve të korruptuar. Armët, narkotikët dhe nafta ilegale kontrabandën nga organizatat kriminale greke, shpesh në bashkëpunim me grupe mafioze shqiptare ose ruse. Rrëmbimi dhe trafiku i armëve janë gjithashtu aktivitete të zgjedhura, shpesh bashkëpunuese me mafien shqiptare. Greqia dhe shumë vende të tjera evropiane, kanë shtuar luftën e tyre kundër kontrabandës, duke bërë arrestime të shumta dhe përndryshe paafësi të organizatave në bashkëpunim me agjencitë evropiane të zbatimit të ligjit.²⁷

2.7. Krimi i organizuar shqiptar

Grupet shqiptare që merren me krimin e organizuar janë relativisht të reja. Në Kosovë u krijuan pas vitit 1999, ndërsa në territorin e Shqipërisë gjatë viteve 1990/91, prandaj karakterizohen si organizata pa struktura të rregullta, të ndërtuara mbi baza familjare, shoqërore, miqësore, krahinore me qëllim që të siguronin fitime e pasuri të shpejta. Në Shqipëri grupet preferonin vjedhjet në ish pasurinë shtetërore e atë shoqërore, falsifikim të dokumenteve për largimin jashtë shtetit, kontrabandën e mallrave, etj. Më pas, sidomos në vitet 1993/96, organizatat kriminale erdhën duke u konsoliduar dhe duke marrë forma të reja kriminale siç ishin firmat piramidale që bënë mashtrimin e qytetarëve dhe pastrimin e parave të pista, kontrabandën e naftës, cigares e mallrave të tjera, trafikimin e drogës, klandestinëve, etj. Në Shqipëri dhe Kosovë, u krijua bindja se “marrja me këtë veprimtari është biznesi më produktiv, i cili mundëson pasurimin e shpejtë, pa përgjegjësi ligjore dhe privilegje të shumta

²⁶ . <https://web.archive.org/web/20131029201850/http://news.pathfinder.gr/greece/news/452071.html>

²⁷ . <http://cyprus-mail.com/2014/04/26/greek-man-extradited-to-cyprus-to-face-drugs-charges>.

kombëtare”.²⁸ Pozicioni i favorshëm gjeografik dhe sidomos dobësia e institucioneve shtetërore për zbatimin e ligjit dhe drejtësinë po e shfrytëzojnë grupet e brendshme kriminale për tu pasuruar sa më shpejtë, si dhe grupet kriminale nga vendet fqinje dhe nga diaspora shqiptare në Evropë e vende të tjera.²⁹ Krimi i organizuar vlerësohet si një rrezik real për sigurinë e çdo shteti, por në mënyrë të veçantë, për sigurinë e shteteve me demokraci të pa konsoliduar dhe institucione të brishta, që s’kanë as forcën dhe as përvojën e duhur për t’u përballur në mënyrë efektive me të. Në këtë këndvështrim, për Shqipërinë ky fenomen vlerësohet si rrezik kryesor për sigurinë e çdo qytetari.³⁰

2.8. Kuptimi dhe objekti i politikës kriminale

Shprehja “politikë kriminale” po gjen përdorim gjithnjë e më të shpeshtë në fjalorin e përditshëm, jo vetëm të specialistëve të drejtësisë, të kriminologëve dhe hartuesve të politikave, por edhe në radhët e mediave e të publikut të gjerë. Kjo shprehje njihet përcaktim të ndryshme, të cilat në më të shumtën e rasteve, janë të lidhura me konceptet e ndryshme që ekzistojnë, lidhur me këtë disiplinë dhe përmbajtjen e saj. Në fjalorin e shqipes së sotme, politika përkufizohet si “*veprimtaria e pushtetit, në marrëdhëniet me shtetet e tjera*”. Ndërsa, koncepti i “*politikës kriminale*” ka të bëjë me një veprimtari të institucioneve të drejtësisë penale dhe të organeve të tjera të ngarkuara me ligj për ruajtjen e rendit shoqëror, veprimtarinë e ligjshme të publikut, parandalimin e krimit dhe të kriminalitetit.

Politika kriminale është një koncept i gjerë dhe konceptohet ndryshe në kohë dhe vende të ndryshme. Ajo është një disiplinë teorike dhe praktike që merret me parandalimin e kriminalitetit, si dukuri individuale dhe kolektive; përfshin studimin e strategjisë së përgjithshme të luftës kundër kriminalitetit, si dhe masat e mjetet e tjera që përdor shoqëria ndaj këtij fenomeni. Prandaj, në tërësi politika kriminale kuptohet si sistem i masave preventive dhe represive me të cilat mbrohet shoqëria nga krimi, duke pasur parasysh edhe respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.³¹ Në këtë kontekst, detyrë kryesore e politikës kriminale shfaqet organizimi i luftës dhe i mbrojtjes efikase nga kriminaliteti, duke pasur parasysh parandalimin dhe represionin juridiko-penal. Elementët kryesorë të politikës kundër krimit kanë të bëjnë me: legjislacionin, institucionet shtetërore, programet dhe strategjitë që zbatohen. Nisur nga rrezikshmëria që paraqet krimi i organizuar, kompleksiteti, veçoritë dhe vështirësitë

²⁸. Intervistë me Prokuror e Shtetit(Kod 20), realizuar në qershor 2014.

²⁹. Shala. XH, “Siguria kombëtare dhe sfidat e integritetit”, Tiranë: Qendra Shqiptare e Studimeve për Sigurinë Kombëtare, 2003.

³⁰. Po aty

³¹. V. Hysi, “Kriminologjia”, Tiranë: Kristalina-KH, 2005.

e parandalimit, komuniteti botëror në vazhdimësi ka përgatitur mjete të ndryshme dhe organizuar institucione të veçanta për t’u marrë me këtë dukuri. Të dy organizmat, Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës për luftën kundër krimit të organizuar kanë marrë një sërë masash të natyrës politike, ligjore dhe institucionale, për të luftuar këtë dukuri kriminale me rrezikshmëri të madhe. Linjat kryesore të kësaj politike parashikojnë se:

- Mjetet dhe metodat e luftës kundër krimit duhet të respektojnë parimet demokratike të shtetit të së drejtës dhe të drejtat e njeriut;
- Sistemi i drejtësisë penale duhet të sigurojë mbrojtjen e interesave të viktimës dhe politika kriminale duhet të krijojë mundësitë e kompensimit të dëmeve që ka pësuar viktima;
- Politika kriminale duhet të orientohet drejt parandalimit të krimit. Qëllimi është që të përdoren të gjitha mjetet dhe format për parandalimin e tij të përgjithshëm dhe të posaçme nga ana e shtetit dhe shoqërisë;
- Politika kriminale duhet të ndërthuret dhe bashkëpunojë me politikat e tjera të shtetit në fushat ekonomike, sociale, etj.;
- Politika kriminale dhe sistemi i drejtësisë penale do të jenë efikase, nëse do të sigurohet pjesëmarrja e gjerë e komunitetit në parandalimin e krimit, pra do të sigurohet mbështetja e tij në të gjitha fushat (ekonomike, sociale, etj.);
- Për zhvillimin e politikës kriminale duhet të bëhen analiza, studime dhe kërkime shkencore, me qëllim që të gjenden dhe aplikohen mjete e alternativa të efektshme parandalimi;
- Politika kriminale kërkon të punohet me plane apo strategji të përgjithshme dhe të veçanta sipas drejtimeve ose tendencave.³²

Drejtimit kryesore të politikës evropiane parashikojnë:

- ✚ Kompletimi i legjislacionit për policinë dhe për bashkëpunimin gjyqësor në vendet e BE-së, krijimi i hapësirave të duhur ligjore për funksionimin e tyre dhe garantimi i të drejtave të qytetarëve;
- ✚ Trajtimi i politikës kriminale si pjesë e politikës së jashtme, sepse lufta kundër krimit të organizuar kërkon edhe impenjimin e vendeve që synojnë të hyjnë në BE;

³². D. Zimmermann, “The European Union and post 9/11 Counterterrorism: A Reappraisal”, *Studies in Conflict and Terrorism*, volume 29, nr. 2 March 2006.

✚ Hartimi i politikave kriminale specifike për forma të veçanta të krimit të organizuar, për shkak të veçorive specifike që shfaqin.³³

Orientimet kryesore në luftën kundër krimit të organizuar formulohe si më poshtë vijon:

- ❖ Politika kriminale kundër krimit të organizuar duhet të konceptohet dhe zhvillohet në mënyrë të planifikuar, duke hartuar strategji komplekse në fushat, ligjor, institucional, administrativ, edukativ, ekonomik, financiar, informativ, operacional, etj.;
- ❖ Politika kriminale duhet të krijojë mundësinë e zbulimit, hetimit dhe dënimit të formave të ndryshme të krimit të organizuar;
- ❖ Përgatitja, kualifikimi dhe specializimi i punonjësve të Policisë, Prokurorisë dhe Gjykatës për të luftuar krimin e organizuar dhe rritur efikasitetin e parandalimit të këtyre veprimtarive kriminale;
- ❖ Krijimi i strukturave të përshtatshme dhe të specializuara për të përballuar luftën kundër krimit të organizuar sipas drejtimeve e formave të kësaj veprimtarie, e veçanërisht në drejtim të veprimeve financiare;
- ❖ Konfiskimi i pasurisë, të ardhurave dhe mjeteve që rrjedhin nga krimi i organizuar dhe kalimi i barrës së provës, pra provimin e origjinës së pasurisë së individit;
- ❖ Marrja e masave mbrojtëse ndaj viktimave të mundshme të krimit, dëshmitarëve dhe personave të penduar, të cilët bashkëpunojnë për zbulimin e veprimtarisë kriminale;
- ❖ Bashkëpunimi i institucioneve të zbatimit të ligjit dhe atyre të drejtësisë me organet homologe për të luftuar në kohë krimin e organizuar, duke shkëmbyer informacione, kryer veprime operative dhe procedurale të përbashkëta;
- ❖ Përdorimi i teknologjisë të informimit për sigurimin e provave siç janë; përgjimin, kontrolli i korrespondencës, etj.;
- ❖ Politika evropiane ndaj krimit të organizuar potencon se bërja e analizave dhe studimeve për të evidentuar gjendjen, format, mënyrat, e krimit të organizuar, është kusht pa të cilin nuk mund të parandalohet dhe luftohet me sukses kjo veprimtari me rrezikshmëri shoqërore.³⁴

³³ . D. Zimmermman, “The European Union and post 9/11 Counterterrorism: A Reappraisal”, *Studies in Conflict and Terrorism*, volume 29, nr. 2 March 2006.

³⁴ . D. Zimmermman, “The European Union and post 9/11 Counterterrorism: A Reappraisal”, *Studies in Conflict and Terrorism*, volume 29, nr. 2 March 2006.

Kapitulli III

3. Format e Krimi të Organizuar Transnacional

Krimi transnacional është bërë një nga “bizneset”, më fitimprurëse në botën bashkëkohore. Paraja është motivi kryesor për këto aktivitete të paligjshme. Fitimi nga krimi i organizuar në nivel global sillet midis 1.6 trilion dollarëve deri në 2.2 trilion dollarëve në vit, me të cilat financojnë dhunën, korrupsionin dhe abuzimet e tjera³⁵. Krimi i organizuar minon ekonomitë kombëtare dhe ndërkombëtare, shkatërrojnë mjedisin dhe rrezikojnë shëndetin dhe mirëqenien e publikut. Bazuar në të dhënat e ofruara nga ky hulumtim, u bëjmë thirrje qeverive, ekspertëve, sektorit privat dhe shoqërisë civile, grupeve të interesit që adresojnë problemet e sistemin global të sigurisë ndaj krimit të organizuar duke promovuar transparencën financiare për të gjitha korporatat, bizneset me vlera të mesme e të mëdha.

a.) Vlera me pakicë e krimit transnacional- Sipas Global Financial Integrity


Tabela 1. Vlera me pakicë e krimit transnacional

Krimi Transnacional	Vlera vjetore e krimit transnacional (në US \$)
1.Trafikimi i drogës	426 miliardë dollarë deri 652 miliardë \$
2.Trafikimi me armë të vogla dhe armë e lehta	1.7 miliardë dollarë deri 3.5 miliardë \$
3.Trafikimi i qenieve njerëzore	150.2 miliardë \$
4.Trafikimi i organeve	840 milion dollarë deri 1.7 miliardë \$
5.Trafikimi i pasurisë kulturore	1.2 miliardë dollarë deri në 1.6 miliardë \$
6.Falsifikimi	923 miliardë dollarëve deri 1.13 trilion \$
7.Tregtia e paligjshme e jetës së egër	5 miliardë në 23 miliardë \$
8. IUU Peshkimi	15.5 miliardë dollarë - 36.4 miliardë \$
9. Prerjet ilegale	52 miliardë dollarë - 157 miliardë \$
10. Minierat e Paligjshme	12 deri në 48 miliardë \$
11. Vjedhja e naftës bruto	5.2 miliardë dollarë - 11,9 miliardë \$
Totali	1.6 trilionë dollarë deri në 2.2 trilion \$.

Tabela nr.1. Krimi i organizuar transnacional fitimi brenda nje viti.³⁶

³⁵ . Global Financial Integrity: Transnational Crime and the Developing World, faq..13, March 2017.

³⁶ . Global Financial Integrity: Transnational Crime and the Developing World, faq.15, March 2017.



Tabelari nr.2. Tregjet kriminale, mesatarja globale në gjashtë mujorin e parë 2021 ³⁷

Sipas të dhënave të Global Organized Crime Index-në 10 tregjet kriminale trafikimi i qenieve njerëzore është më i përhapuri në nivel global, i ndjekur nga trafikimi me kanabis , i pasuar nga trafikimi me armë. Si duket Pandemia Covid 19 ka paraqitur sfida për trafikantet e krimit të organizuar ngase për këtë periudhë kohore krimi i organizuar në nivel global ka pas rrënje.

3.1. Krimi i Organizuar (Trafikimi i Drogës)

a.) Pasqyra e krimit të organizuar -trafikimi i drogës

Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC) përcakton trafikimin e drogës në "kultivimin, prodhimin, shpërndarjen dhe shitjen e substancave që janë subjekt i ligjeve të ndaluara të drogës. ”Trafikimi me Droga është krimi transnacional, asnjë vend nuk mbetet i paprekur nga ky fenomen, duke filluar nga kontrollimi, nga operacionet e prodhimit dhe të përpunimit, deri të aktivitetet e shpërndarjes dhe konsumit. Trafikimi i drogës ka një efekt destabilizues për të gjitha vendet e botës, ku më pak e ku më shumë, pavarësisht nëse ato janë vend burimi, vend përpunimi, vend tranzitimi ose vendi i tregut.

b.) Vlera e trafikimit me drogë

Trafikimi i drogës është tregu i dytë i paligjshëm nga i cili krijohen përfitime kriminale, bazuar në raportin e Global Financial Integrity, trafikimi me lëndë narkotike, drogë përfaqëson më shumë sesa 1/3 e vlerës totale të krimeve transnacionale. Sidoqoftë, çdo diskutim mbi vlerat

³⁷ . Global Organized Crime Index, 2021, faq. 15

e tregut global të trafikut të drogës, është vështirë të përcaktohet realisht vlera e përfitimit kriminal. Vështirësia kryesore lind nga fakti që operacionet dhe transaksionet janë të fshehta. Si rezultat, shumica e të dhënave në dispozicion vijnë nga konfiskimet e drogës të cilat paraqesin një përqindje të vogël të trafikut aktual të drogës. Përveç kësaj, nuk ekziston një shifër ndërkombëtare e dakorduar për përcaktimin e trafikut të drogës. Kështu, vendet e ndryshme raportojnë masat dhe aktivitetin e trafikimit me drogë në mënyrë të ndryshme, duke u bazuar në të dhëna që janë të disponueshme. Vlera e tregut global në trafikun e drogës rrjedh nga shitja me pakicë e katër kategorive kryesore të drogës të paligjshme: kanabis, kokainë, opiumi dhe stimulues të llojit amfetaminë (ATS). Në raportin e Global Financial Integrity vlerësohet se tregu global në trafikun e drogës ishte me vlerë nga 426 miliardë dollarë në 652 miliardë dollarë në vitin 2017.³⁸

Lloji	Vlera e tregut
Kanabisi	183 miliardë dollarë - 287 miliardë dollarë
Kokainë	94 miliardë dollarë - 143 miliardë dollarë
Opium	75 miliardë dollarë - 132 miliardë dollarë
ATS	74 miliardë deri në 90 miliardë dollarë
Total-Global	426 miliardë dollarëve deri në 652 miliardë dollarë

Tabela nr. 3. Përmbledhje të vlerave të tregut global për të gjithë trafikun e drogës.³⁹

Siç shihet në tabelën përmbledhëse të trafikut të drogës në botë, tregu global i trafikut të drogës ishte me vlerë nga 426 miliardë dollarë deri në 652 miliardë dollarë në vitin 2017. Ai përfaqëson rreth 1/3 e vlerës totale të shitjes me pakicë të të gjitha krimeve transnacionale të studiuara. Kanabisi përbënte pjesën më të madhe të trafikut të drogës, të ndjekur nga kokaina, opiumit, dhe stimuluesit e llojit të amfetaminës (ATS). ATS dhe kanabisi prodhohen gati në të gjithë shtetet e botës, ndërsa prodhimi i kokainës dhe opiumëve është përqëndruar në Amerikën e Jugut dhe Afganistan.

Vendi-shteti	Çmimi për kilogram	Rritja e çmimit dhe prodhimi
Brendësia e Kolumbisë	2,200 \$.	/
Portet Kolumbiane	5,500 - 7,000 \$	150% -218%
Amerika Qendrore	10,000 \$	355%
Meksika Jugore	12,000 \$	445%
Meksika Veriore	16,000 \$	627%
Shtetet e Bashkuara	24,000 - 27,000 \$	991% -1,127%
Evropë	53,000 - 55,000 \$	2,309% -2,400%

³⁸ . Global Financial Integrity: Transnational Crime and the Developing World, faq. 14, March 2017.

³⁹ . Global Financial Integrity: Transnational Crime and the Developing World, faq. 15, March 2017.

Australia	200,000 \$	8991%
------------------	-------------------	--------------

Tabela 4. Çmimet, Kokaina Kolumbiane (US- \$, rrugë me shumicë)

3.2. Krimi i organizuar-Trafikimi i Armëve

Trafikimi i armëve të vogla dhe të lehta (SALW) përbën një nga krimet e organizuara ndërkombëtare i cili renditet më pak fitimprurës krahasuar me trafikimin e drogës, dhe disa veprimtarive të tjera kriminale, të studiuara në hulumtimin e Global Financial Integrity, por që konsiderohet si krim me pasojat për sigurinë njerëzore në vendet në zhvillim. Ky treg kriminal sipas studimeve të zhvilluara nga Global Financial Integrity kishte vlerën nga 1.7 miliardë dollarë deri në 3.5 miliardë dollarë në vitin 2017. Janë disa faktorë kryesorë që nxisin ngritjen e çmimeve: a.) niveli i konfliktit në një zonë; b.) trazira politike dhe c.) tensioni politik; dhe d.) distanca mbi të cilët bëhet kontrabanda e armëve. Trafikimi i bazuar në internet paraqet një sfidë në rritje për të luftuar kontrabandën e armëve të vogla dhe të lehta(SALW).

a.) Pasqyra e trafikimit me armë të vogla dhe të lehta

Trafikimi i armëve të vogla dhe të lehta ka ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë dhe zhvillimin e një shteti. Trafikimi i armëve është i paligjshëm së bashku me pjesët e tyre, aksesoreve dhe municioneve që pothuajse kanë shtrirje në të gjithë kufijtë ndërkombëtarë.⁴⁰

Armët e vogla	Përshkrimi i tregut
Armët e vogla	Armët e vogla janë armë për përdorim individual. Kjo kategori përfshin revolverë dhe pistoleta; pushkë dhe karabina; çifte; mitraloza; dhe mitraloza të lehta.
Armët e lehta	Shumica e armëve të lehta kërkojnë një ekip të vogël për operim. Kjo kategori përfshin mitraloza të rënda; të sistemit të kalibrave 120 mm ose më pak; të mbajtura me dorë, dhe lëshues granat automatik; granata dore; raketa portative; mina; dhe pajisje shpërthyes të improvizuara.
Pjesët dhe Komponentët	Pjesët dhe përbërësit i referohen çdo elementi ose zëvendësues "të krijuar posaçërisht për një armë zjarri, thelbësore për funksionimin e tij.
Aksesorë	Një aksesori është "një pjesë që i bashkëngjitet fizikisht armës dhe e rrit efektivitetin ose dobinë, por, në përgjithësi, nuk është thelbësore.

⁴⁰ . Schroeder. M, “Dribs and Drabs: The Mechanics of Arms Small Trafficking from the United States” (Gjenevë: Small Arms Survey, 2016), 2, 13, <http://www.smallarmssurvey.org/fileadmin/docs/G-Issue-briefs/SAS-IB17-Mekanika-e-trafikimit.pdf>; Janis Grzybowski, Nicholas Marsh dhe Matt Schroeder, "Piece by Piece: Transferime të Autorizuara të Pjesëve dhe Aksesoreve", në Anketa e Armëve të Vogla 2017: Lëvizja e Synimeve (Gjenevë: Anketa e Armëve të Vogla, 2016), 245, <http://www.smallarmssurvey.org/fileadmin/docs/A-Yearbook/2012/arm/Small-Arms-Survey-2016-Cha-Chapter-08-EN.pdf>; Kombet e Bashkuara, “Protokollit kundër Prodhimit dhe Trafikimit të Paligjshëm të Armëve të Zjarrit, Pjesëve dhe Përbërësve të tyre dhe Municionit, Shtojcë e Bashkuar Konventa e Kombeve kundër Krimit të Organizuar”, Pub. L. Nr. A / RES / 55/255 (2001), 2–3.

	Shembuj të aksesorëve përfshijnë; laser që synojnë; pajisjeve vizionate; rreshtat e laserit; dhe sistemet e kontrollit të zjarrit.
Municion	Municioni është "raundi i plotë ose përbërësit i përdorur për armët e zjarri". Shembuj përfshijnë plumba ose predha; rastet e fishekëve; dhe pluhur shtytës.⁴¹

Tabela 5. Jep një përshkrim të përbërësve të ndryshëm të armëve të paligjshme

a.) Vlerat e tregtisë me armë

Qëndrueshmëria e tregtisë së armëve e bënë të vështirë përcaktimin e vlerës së tregut të saj. Vendet e ndryshme raportojnë vullnetarisht të dhënat e tyre të tregtisë bazë me armë dhe municion, të dhënave nga raportet e Kombeve të Bashkuara (KB), disa raportime të qeverive të vendeve të ndryshme mund të mos jenë raport i plotë, me të dhëna të sakta, në trafikimin klandestine të armëve. Sipas raporteve tregtia globale e armëve kishte vlerën 17.3 miliardë dollarë amerikan, ka shumë mundësi që kjo vlerë është nënvlerësuar, respektivisht mund të jetë shumëfish më e lartë.

Shteti-Vendi	Çmimi	Vendi	Çmimi
Afganistan	600- 1,500 \$	Internet(Dark web)	2,800 - 3,600 \$
Belgjikë	1,135 \$	Pakistan	1,205 \$- 148 \$
Indi	1,087- 9,058 \$	Somali	350\$ -750 \$
Meksika (në kufirin verior)	1,200 - 1,600 \$	Siri	1,200 \$-2100\$
Nigeria	1,292 \$	Jemen	1,396 \$

Tabela nr.6.Kostoja mesatare e një AK-47 në të gjithë botën (US \$.)⁴²

Ka shumë faktorë që ndikojnë në çmimin e një arme, disa përcaktues të çmimit të armëve janë të lidhur me mjedisin e tregut dhe të tjerët me tipin e armës. Paqëndrueshmëria politike, përbënë shtytësit më të fortë si të vëllimit të shitjes ashtu edhe të çmimeve. Sa më i lartë niveli i konfliktit, trazirave, luftës civile ose tensioneve politike, çmimi rritet. Nëse kërkesa është e lartë, çmimi i armëve rritet është më i lartë, pa marrë parasysh furnizimin me armë.

3.3.Trafikimi me qenie njerëzore

Trafikimi me qenie njerëzore konsiderohet si skllavëria moderne, ai është një nga krimet më të rënda të shkeljes së të drejtave, lirive dhe dinjitetit të njeriut. Pasojat e trafikimit shtrihen mbi individët, që bien pre, viktimë e grupeve kriminale, komunitetet lokale,

⁴¹ . Burimet: Schroeder. M.; Grzybowski, J. Nicholas Marsh dhe Schroeder. M; Kombet e Bashkuara

⁴² . Burimet: Schroeder. M, Grzybowski. J,& Nicholas. N dhe Schroeder. M; Kombet e Bashkuara

kombëtare, rajonale e ndërkombëtare. Natyra e kësaj veprimtarie kriminale, ka shtrirje të gjerë gjeografike, kjo veprimtari kriminale siguron të ardhura marramendëse. Trafikimi i njerëzve i referohet "rekrutimit, transportit, strehimit ose marrjes së personave, me anë të mjeteve të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit ose shpërdorimit të pushtetit ose dobësisë, me qëllim të shfrytëzimit, " me shfrytëzim, përfshirë, së paku, "shfrytëzimin seksual, punën e detyruar, skllavërinë ose skllavërinë praktikë".⁴³ Rreth 21 milion burra, gra dhe fëmijë në të gjithë botën janë viktima të trafikimit me qenie njerëzore.⁴⁴ Trafikimi me qenie njerëzore u shfaq si problem shoqëror në fund të shekullit të XIX-të. Ndryshimet e ndodhura në Evropë dhe Amerikën e Veriut erdhën si pasojë e industrializimit, urbanizimit dhe shpërndarjes së pabarabartë të mirave që ndikuan nga migrimi, të cilat shoqëroheshin me shqetësime për lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave. Migrimet ndikuan në ndryshimin e tregut të punës si dhe në rritjen e kërkesës për punë në "industrinë seksuale" në shtetet e Perëndimit. Këto kërkesa u plotësuan, kryesisht, nga emigrantët të cilët trafikoheshin nga vendet e varfëra. Në atë kohë trafikimi u përkufizua si "transportim i grave" përgjatë kufijve, për shfrytëzim seksual. Historikisht, vëmendja ndaj trafikimit të grave ka qenë e përqendruar në trafikimin e grave për prostitucion. Në vitin 1921 u miratua konventa, nën mbikëqyrjen e Lidhjes së Kombeve, e cila ndihmoi në ligjërimin e përpjekjeve anti-trafik. Kjo konventë zgjeroi mbrojtjen e minoriteteve, të dy sekseve, rriti moshën e dhënies së pëlqimit në 21 vjeç, siguroi ekstradimin e trafikantëve dhe kërkoi masat legjislative ose administrative, shtetërore, për të kontrolluar agjencitë e punësimit.⁴⁵ (League of Nations, 1921). Gjatë shekullit të XIX, përpjekja për ndalimin e skllavërisë dhe tregtisë së skllavëve është mundësuar (kryer) nga, më së shumti, të nxitura nga Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës miratuan traktatet dy-palëshe në të cilën palët zotoheshin që të ndiqnin penalisht dhe ndëshkonin me dënime të rënda tregtarët e skllavëve. Traktati i parë shumë-palësh u përshtat nga Lidhja e Kombeve (LK) në 1926 (Slavery Convention, 1926). Nëse i referohemi Nenit 1(2), të traktatit, shprehimisht thuhet "tregtia e skllavëve përfshin "të gjitha veprat e përfshira në kapjen, përvetësimin ose kontrollin/dhënien e një personi me qëllimin e vënies së tij në skllavëri; të gjitha veprat e përfshira në përvetësimin e një skllavi me prirjen për ta shitur apo shkëmbyer atë"⁴⁶. Konventa Suplementare e Skllavërisë 1956 synoi përditësimin e ligjit duke e zgjeruar zbatimin e

⁴³. International Labour Organization, *Profits and Poverty*, 14, 17.

⁴⁴. International Labour Organization, *Profits and Poverty*, 15, 17.

⁴⁵. League of Nations, 1921.

⁴⁶. Slavery Convention, 1926.

Konventës mbi institucionet dhe praktikat e ngjashme me skllavërinë, duke përfshirë skllavërinë nëpërmjet borxhit dhe robërinë.⁴⁷ Kjo konventë detyron Shtetet Palë që të kriminalizojnë skllavërimin e një personi (neni. 6) “tregtinë e skllevërve” (neni 3), duke përfshirë përpjekjen e përfshirjes (bashkëpunimit) dhe konspiracionit për të kryer këto vepra⁴⁸. Marrëveshja ndërkombëtare mbi nevojën për të luftuar trafikimin u konsolidua në dhjetor të vitit 2000 kur shtetet nënshkruan Protokollin e Trafikimit të Personave, i pari instrument ligjor ndërkombëtar që përcaktoi detyrimet e shtetit për të parandaluar, shtypur dhe ndëshkuar trafikimin. Protokollin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore është mjete i parë preferencial që përdoret nga vendet për të zhvilluar qasjet e tyre në luftën kundër kësaj dukurie, për të formësuar strukturat e politikave rajonale dhe udhëzuar bashkëpunimin ndërkombëtar në këtë fushë. Protokollin hyri në fuqi me 25 Dhjetor 2003, në Shkurt të 2009 u nënshkrua nga 124 shtete. Pas vitit 2000, në përgjigje të Protokollit të ri të KB mbi Trafikimin (Protokollin e Palermos 2000) dhe ndryshimit në legjislacionin e BE-së, shumë shtete zgjeruan përkufizimin e krimit duke përfshirë trafikimin e djemve dhe burrave, përmirësimin e konceptit të mashtrimit dhe shtrëngimit (detyrimit) të përdorur për të rekrutuar dhe mbajtur femrat në shfrytëzim seksual, si dhe rritjes së shkallës së dënimit për trafikantët.

a. Traktatet ndërkombëtare

Tre traktatet që lidhen drejtpërdrejtë me trafikimin dhe kalimin kontrabandë të migruarve janë: “Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar” (UNTOC), “Protokollin e OKB-së për Trafikimin” dhe “Protokollin e OKB-së për Kontrabandën”, të gjitha të miratuara në Dhjetor të vitit 2000.

b. Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (UNTOC)

Kjo Konventë është instrumenti qendror i një pakete traktatesh të hartuara për të trajtuar krimin e organizuar ndërkombëtar (KON). Protokollin e veçanta që i janë bashkëlidhur UNTOC trajtojnë konkretisht trafikimin, kalimin kontrabandë të migruarve dhe trafikimin e armëve të vogla.

c. Protokollin e OKB-së kundër trafikimit

“Protokollin e OKB-së për Parandalimin, Ndalimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore, sidomos të Grave dhe Fëmijëve, i cili plotëson Konventën e OKB-së

⁴⁷ . **Supplementary Convention on the Abolition of Slavery, the Slave Trade, and Institutions and Practices Similar to Slavery, 1956).**

⁴⁸ . **Po aty**

kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar” është më i rëndësishmi nga të gjithë traktatet ndërkombëtare për trafikimin.

Trafikimi i qenieve njerëzore, për punë dhe seks, është një nga krimet e organizuara transnacionale me rritje më të shpejtë në tregjet e botës. Njëzet e një milion burra, gra dhe fëmijë në mbarë botën aktualisht mendohet se janë viktima të trafikimit njerëzor, vlerëson Organizata Ndërkombëtare e Punës, kjo formë e krimit të organizuar gjeneron për organizatat kriminale të trafikimit mbi 150.2 miliardë dollarë fitime çdo vit.


a. Pasqyrë e krimit me qenie njerëzore

Me gjithë brutalitetin dhe shkatërrimet që sjell në jetën e njerëzve, trafikimi me qenie njerëzore është i motivuar që të maksimizojë fitimet, shfrytëzimin e njerëzve për punë ose seks. Fitim i lartë dhe dënimet e ultë kanë tërhequr grupet e krimit të organizuar (OCG).

b. Vlera e trafikimit me qenie njerëzore

Trafikimi i qenieve njerëzore është një biznes jashtëzakonisht fitimprurës. Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) vlerëson se trafikimi i qenieve njerëzore gjeneron mbi 150.2 miliardë dollarë fitime çdo vit, për trafiqet e paligjshme, shih grafikunin 1 dy rajone; Azi-Paqësori, Ekonomitë e Zhvilluara dhe Bashkimi Evropian përbëjnë përafërsisht 1/3 të fitimeve globale, respektivisht, 51.8 miliardë \$ ndërsa 46.9 miliardë \$ amerikanë, katër rajonet e mbetura. Rajoni i Azisë dhe Paqësorit ka afërsisht 11.7 milion viktima, gati tetë herë më të mëdha se në Ekonomitë e Zhvilluara dhe BE (1.5 milion), megjithatë, fitimi vjetor për viktimë është 5,000 dollarë amerikanë ndërsa Ekonomitë e zhvilluara dhe BE kanë 34.800.93 dollarë amerikanë.⁴⁹

⁴⁹ . International Labour Organization, *Profits and Poverty*, 16, 18.




Grafikoni nr. 1. Fitimet vjetore të vlerësuar nga trafikimi me qenie njerëzore sipas rajoneve (miliardë dollarë amerikanë).⁵⁰ Fitimet dhe viktimat



Grafik. Nr.2. Fitimet Vjetore nga Trafikimi i Njerëzve nga Sektori (miliarda dollarë amerikanë)

Sipas statistikave të ONP-së, fitimet më të mëdha vjetore vijnë nga shfrytëzimi seksual i detyruar (66%, 99 miliardë), me një fitim mesatar vjetor prej 21.800 US \$ për viktimë.

⁵⁰ . International Labour Organization, *Profits and Poverty*, 16, 18.



Grafikani.3. (Burimi: Organizata Ndërkombëtare e Punës † Përfshijon punën e detyruar të imponuar nga shteti. * Përfshinë punë të brendshme dhe jo shtëpiake.⁵¹

Shfrytëzimi i punës së detyruar prek numrin më të madh të viktimave (14.2 milion, ose 68 %), i cili gjeneron më pak fitime (51.2 miliardë dollarë amerikanë) sesa shfrytëzimi seksual.⁵² Ka më shumë veprimtari të përfshira (p.sh., ndërtimtari, miniera dhe bujqësi), që prek një numër më të madh të viktimave të shfrytëzuara. Fitimi mesatar vjetor për viktimë është 2,300 dollarë amerikanë nga puna e dhunshme shtëpiake dhe 2500 deri 4800 dollarë amerikanë nga puna shtëpiake.⁵³ Puna e detyruar e vendosur nga shteti përfaqëson më pak se 11 % (2.2 milion) të gjithë trafikimit me qenie njerëzore, duke përfshirë veprime të tilla si puna e detyruar në burg dhe shfrytëzimi i punës ushtarake dhe paramilitare (duke përjashtuar ligjet e shërbimit të detyrueshëm).⁵⁴

c. Dinamika e trafikimit me qenie njerëzore

Ka rreth 21 milion viktima të trafikimit me njerëz në të gjithë botën, të shfrytëzuar nga individë, grupe dhe biznese për qëllime seksuale ose punë.⁵⁵ Shfrytëzimi seksual më shpesh i referohet prostitucionit por mund të përfshijë edhe pornografi. Shfrytëzimi i punës zakonisht përfshin punë të ulëta ose të pakualifikuara në industri të tilla si bujqësia, pylltaria, peshkimi,

⁵¹ . International Labour Organization, *Profits and Poverty*, 16, 17.

⁵² . International Labour Organization, *Profits and Poverty*, 18, 19

⁵³ . International Labour Organization, *Profits and Poverty*, 19, 19

⁵⁴ . International Labour Organization, *Profits and Poverty*, 20, 20

⁵⁵ . International Labour Organization, *Profits and Poverty*, 21, 22

ndërtimi, minierat dhe prodhimi i brendshëm pune i nënshtrimit të punës, që përfaqëson afërsisht 24 % të gjithë shfrytëzimit, gjenerimit të punës që paraqet nivel më të ulët të fitimit.⁵⁶

3.3. Tregtia e paligjshme e organeve

Trafikimi i organeve njerëzore paraqet fenomenin më të shëmtuar, bizar të krimit të organizuar, kjo tregti gjeneron në mënyrë konstante afërsisht nga 840 \$ deri në 1.7 \$ miliardë dollarë në vit nga rreth 12,000 transplantime të paligjshme. Në këtë lloj të krimit hyjnë "shitjet" e pesë organeve kryesore të njeriut siç janë: veshkat, mëlçisë, zemrës, mushkërive dhe pankreasit. Veshkat janë më të zakonshmet për transplantime të ligjshme dhe të paligjshme, çmim në tregun e zi i transplantimit të veshkave është më i lirë nga organet tjera, sepse ato mund të vijnë nga dhuruesit e gjallë. Në shumë raste dhuruesi merr pjesë me dëshirë, ndërsa ka skenarë kur ato shtypen ose detyrohen të futen në transaksion. Trafikantët e organeve detyrojnë emigrantët dhe refugjatët të shesin veshka për të paguar kalimin kryesisht në Evropë, por edhe në vende të tjera.

a. Pasqyrë e trafikimit me organe

Tregtia e paligjshme e organeve ka pasoja të rënda për individët dhe komunitetin, dëshpërimi dhe lakmia e shtyjnë tregtinë e paligjshme të organeve. Marrësi dhe shitësi janë të dëshpëruar, marrësi mund të jetë duke u përballur me një vdekje, përveç nëse ata marrin një transplanto, shitësi kërkon të lehtësojë borxhin ose shpëtimin nga varfëria.⁵⁷ Edhe pse të dytë po shkelin ligjin, asnjëri nuk i përshtatet imazhit të një tipi kriminal. Janë tregtarët, ndërmjetësit dhe sekserët që mishërojnë vlerat e "çnjerëzimit të njeriut ndaj njeriut" duke u përpjekur të përfitojmë nga vuajtjet e të tjerëve.⁵⁸

b. Vlerat e krimit të transplantit të organeve

Edhe pse vetëm një pjesë e vogël e të gjitha transplanteve të paligjshme e detyruese të organet e njeriut, zbulohen, identifikohen, nga organet e ndjekjes për tu klasifikuar si veprimtari e paligjshme, ndërkaq dënimet janë të ulta krahasuar më fitimet e larta të tregtisë së paligjshme të organeve. Trafikimi me organet e njeriut gjeneron në mënyrë antiligjore afërsisht nga 840 milion \$ deri në 1.7 miliardë \$ në vit. Në këtë grup të tregtisë bëjnë pjesë;

⁵⁶ . po aty 18.

⁵⁷ . The use of the term “vendor” does not necessarily indicate that the individual gave the organ willingly or without coercion, and/or that they were compensated.

⁵⁸ . Bienstock. R. E, *Tales from the Organ Trade*, Documentary (HBO, 2013).

"shitjet" e pesë organeve të njeriut siç janë: veshka, mëlçia, zemra, mushkëritë dhe pankreasi.

Tabela -I- siguron pagesa tipike të përfituesve që paguajnë për këto organe.⁵⁹

Organi	Nr. Trans plantët ilegale-kriminale mesatarja gjatë një viti	Gama e çmimeve
Veshkë	7,995	50,000 deri në 120,000 \$
Mëlçia	2,615	99,000 deri në 145,000 \$
Zemra	654	130,000 deri 290,000 \$
Lukthi	469	150,000 deri 290,000 \$
Pankreasi	233	110,000 deri në 140,000 \$
Gjithsej:	11.966	\$ 840 milion në 1.7 miliardë \$

Tabela 7. Çmimi i shitjes me pakicë i organeve (USA dollarë)

Sipas raporteve të verifikuara 10 % e të gjitha transplanteve të organeve janë fituar në mënyrë të paligjshme. Në vitin 2014, rreth 120,000 transplantime organesh u kryen në të gjithë botën, afërsisht 12,000 transplantime janë kryer në mënyrë të paligjshme atë vit.⁶⁰ (Të dhënat statistikore janë vetëm për rastet e identifikuara, kapura nga organet e drejtësisë, sa e sa raste nuk janë zbuluar, ato nuk bënë pjesë në statistikën e prezantuar). Dy të tretat e këtyre transplantëve të paligjshme ishin transplantë të veshkave, të ndjekura nga transplantime të mëlçisë, zemrës, mushkërive dhe pankreasit. Sipas hulumtimi të bërë nga Organs Watch brenda nj vitit behën të paktën 10,000 transplante të veshkave kështu që shifra 8,000 në raportin më atë të prezantuar mund të jetë e nënvlerësuar.⁶¹ Donatorët e gjallë rrisin furnizimin e organeve në dispozicion, duke ulur kështu çmimin e paguar nga marrësit, të marrë nga donatorët. Për mëlçinë, zemra, mushkëritë dhe pankreasi, çmimet për këto organe janë pothuajse dyfishë të larta pasi ato mund të jenë shumë më e vështirë për t'u fituar.

Tabela nr.8. Transplantet e veshkave: Shitësit kundër Marrësit

Vendndodhja e Transplantim	Shitësi		Marrësi		Shënime Rritja e çmimit
	Vendi	Pagesa	Vendi	Pagesa	
Kina	Kina	\$5,000	Izraeli	\$100,000	1,900%
Kostarika	Kostarika	\$18,500	Izraeli	\$175,000	846%
Kosova	Moldavia	\$12,000	Kanada	\$120,000	900%
Peru	Peru	\$7,000	Meksika	\$125,000	1,686%
Singapor	Indonezi	\$18,700	Singapori	\$237,000	1,166%

⁵⁹ . Bienstock. R. E., “*Tales from the Organ Trade*”, Documentary (HBO, 2013).

⁶⁰ . Global Observatory on Donation and Transplantation, “Organ Donation and Transplantation Activities 2014” (Madrid: Organización Nacional de Trasplantes, April 2016), <http://www.transplant-observatory.org/data-reports-2014>.

⁶¹ . Scheper-Hughes, “Perpetual Scars,,” faq. 15.

Afrika Jugore	Izraeli	\$20,000	Izraeli	\$120,000	500%
Afrika Qendrore	Brazili, Romania	\$6,000	Izraeli	\$120,000	1,900%
SHBA	Izraeli	\$10,000	Izrael -SHBA	\$120,000	1,100%

Burimet: Shikoni Shtojcën, Seksionin C për listën e burimeve.⁶²

Ekziston një pabarazi e konsiderueshme midis tarifës që merr shitësi dhe shumës që paguan marrësit. Siç shihet në Tabelën numër 9, shitësit shpesh marrin mesatarisht më pak se 10 % të çmimit të pagesës, kurse shumica shkon tek ndërmjetësit. Një skemë që përfshin Netcare hospitals në Afrikën e Jugut fillimisht përfshihet një shitës nga Izraeli, i cili paguar 20,000 \$ për një transplantim të veshkës, por agjentët më vonë gjeten shitësit nga Brazili dhe Rumania të cilët ishin të gatshëm të pranonin transplantin për 6,000\$ dollarë amerikanë.⁶³

Tabela.9. Çmimet e paguara për shitësit e veshkave në të gjithë botën

Vendi-shteti	Çmimi i ulte	Çmimi i larte	Vendi-shteti Shitësi	Çmimi i ulët	Çmimi i lartë
Bangladesh	2,000 \$	3,000\$	Libani	3,000 \$	7,000 \$
Bjellorusia	8,000 \$	10,000 \$	Moldavia	2,500 \$	3,000 \$
Brazili	3,000 \$	10,000 \$	Nepal	200 \$	900 \$
Kamboxhia	/	3,000 \$	Nikaragua	/	5,000 \$
Kina	3.500 \$	15,000 \$	Palestina	1.300 \$	2.100 \$
Kolumbia	1.000 \$	3,000 \$	Perua	5,000 \$	12,000 \$
Kosta Riko	5,500 \$	6,000 \$	Filipinet	1.000 \$	2,500 \$
Egjipti	/	2,000 \$	Romania	2.700 \$ \$	6,000 \$
India	1.000 \$	6,000 \$	Siria	/	3.000 \$
Indonezia	5,000 \$	23,000 \$	Turqia	7,500 \$	10,000 \$
Iraku	/	1.000 \$	SHBA	20,000 \$	30,000 \$
Izraeli	10,000 \$	25,000 \$	Vietnam	/	2,400 \$
Japonia	/	16,000\$	Jemen	7,000 \$	7,000 \$
Jordania	\$ 500	50000 \$	/	/	/

Tabelari nr.9.Vlera e veshakëve te shitura ne tregun e zi-Trafikim organesh.⁶⁴

Çmimet e paguara për shitësit e organeve variojnë nga një shtet në shtetin tjetër, pagesat janë të lidhura me shtetin në të cilin bëhet transplantimi. Në tabelarin nr. 10 shihen ndryshimet e çmimeve të shitjes së organeve dhe çmimi që paguhet për transplantin e organeve në disa shtete të botës. Shitësit nga vendet e zhvilluara pothuajse gjithmonë paguajnë më shtrenjtë për transplantin, sesa shitësit nga vendet në zhvillim, për secilin lloj të organit. Për shembull,

⁶² . Scheper-Hughes, “Perpetual Scars,,” faq. 18.

⁶² . Scheper-Hughes, “Perpetual Scars,,” faq. 19.

⁶³ . Swingler. Shaun, “The Dark World of Internet Kidney Trafficking”.

⁶⁴ . Swingler. Shaun, “The Dark World of Internet Kidney Trafficking”.

pagesa mesatare e dhënësit të organit të transplantuar në vendet e zhvilluara është mesatarisht 20,000 \$ amerikane, ndërsa shitësit në vendet në zhvillim marrin 3,000 dollarë amerikane për shitjen e veshkëve të tyre, një ndryshim prej më shumë se 500%. Krahasuar me tregtitë e tjera të paligjshme, trafikimi i organeve ka një impakt shumë më të madh në rrafshin personal dhe në nivelin e komunitetit sesa në sferën e ekonomisë ose në fushën e sigurisë së një vendi. Shumica dërmuese e shitësve janë të paarsimuar dhe dëshpëruar nga vendet e varfëra dhe ato në zhvillim. Sipas statistikave zyrtarë në Siri vlerësohet se që nga fillimi i luftës civile shitjen e organeve, kryesisht veshkëve e kanë bërë 18,000 deri 20,000 siriane.⁶⁵ Nga trafikimi i organeve njerëzore, kontrabandistët gjenerojnë nga 840 milion \$ amerikane deri në 1.7 miliardë \$ në vit.

3.4. Tregtia e paligjshme e pasurisë kulturore

Tregtia e paligjshme e pasurisë kulturore është një krim shumë më i korruptuar dhe me ndikim sesa duket.⁶⁶ Ai mbulon një gamë të gjerë aktiviteteve, nga vjedhja e veprave artistike nga muzeumet, gërmimet, plaçkitjet e paligjshme të vendeve arkeologjike, trafikimin e pasurive kulturore gjatë konflikteve të armatosura, përdorimin e falsifikuar ose dokumentacion të falsifikuar për të mundësuar importin dhe eksportin si dhe transferimet e tyre në pronësi. Më shumë se 152% të kërkesave zakonisht vijnë nga vendet e zhvilluara, në rastet e trafikimit të antikitetëve, furnizimet vijnë nga vendet në zhvillim. Plaçkitja, vjedhja e antikave paraqet sfidën më të madhe në luftimin e krimit të artit, sepse është e vështirë të zbulosh objekte të këputura nga errësira. Mungesa e mbikëqyrjes dhe keqpërdorimi i sistemit global financiar kanë lejuar artin e paligjshëm dhe tregu i antikitetëve të lulëzoj nën hijen e tregut të licencuar. Të ardhurat vjetore globale të krijuara nga tregtia e paligjshme të pronës kulturore vlerësohet afërsisht 1.2 miliardë \$ deri në 1.6 miliardë \$ në vit.⁶⁷ P.sh në vitin 1911 vjedhja e Mona Lizës së Da Vinçit, nga muzeu i Luvri në Paris, Francë u shit 794 milion dollarë. Përhapja e vjedhjeve të artit globalisht të trafikuar të antikitetëve nënvlerësohet për shkak të shumë vjedhjeve që kanë ndodhur pa u vërejtur ose pa u raportuar.

⁶⁵ . Hamdo. A. H, “The Underbelly of Syria’s War: A Thriving Trade in Human Organs,” *UPI*, May 12, 2016, http://www.upi.com/Top_News/World-News/2016/05/12/The-underbelly-of-Syrias-war-a-thriving-trade-in-human-organs/5301462896201/.

⁶⁶ . UNESCO

⁶⁷ . The European Fine Art Foundation, “U.S. Art Market Reports Highest Ever Level of Sales While Overall Global Market Values Fall” (Press Release, Helvoirt, Netherlands, March 2, 2016), <https://www.tefaf.com/getattachment/Press/Press-releases/US-Art-market-reports-highest-ever-level-of-sales-while-overall-global-market-values-fall.pdf?langen-US>.

Vjedhjet dhe shitjet e veprave të shquara të artit

Viti	Vepra arti	Vendi i Vjedhur	Vlera e Vlerësuar
1911	Mona Lisa nga da Vinci	Luvri Paris, Francë	794 milion \$
1990	13 vepra duke përfshirë Stuhinë në Det e Galile nga Rembrandt dhe Koncerti nga Vermeer	Muzeu Isabella Stewart Gardner Boston, Massachusetts, SHBA	500 milion \$
1991	20 piktura përfshirë luledielli dhe Hedhësit e Patates nga Van Gogh	Muzeu Van Gogh Amsterdam, Hollandë	500 milion \$
2008	4 piktura përfshin Lulëkuqet afër Vetheuil nga Monet dhe Djali me një të Kuqe Jelek nga Cézanne	Fondacioni E.G. Bührle Cyrih, Zvicër	163 milion \$
2010	5 vepra arti përfshirë Le Pigeon aux petis pois nga Picasso dhe La Pastorale nga Matisse Francë	Musée d'Art Moderne de la Ville de Paris Paris.	123 milion \$
2004	The Scream (1910) dhe Madonna by Munch	Muzeu Munch Oslo, Norvegji	121 milion \$
2002	Dy vepra nga Van Gogh përfshirë Pamja e detit nga Scheveningen	Muzeu Van Gogh Amsterdam, Holandë	100 milion \$
2007	Tre vepra duke përfshirë Maya dhe Kukulla dhe Portreti i Zhaklinës nga Picasso	Rezidencë private Paris, Francë	68 milion \$
2010	Lule me lulekuqe nga van Gogh	Muzeu Muhamed Mahmoud Khalil Kajro, Egjipt	55 milion \$
2003	Madonna of the Yarnwinder nga da Vinci	Kalaja e Drumlanrigut Dumfriesshire, Skoci	47 deri 79 milion \$

Tabelari nr.10.Vlera e trafikimit dhe shitja në tregun e zi të veprave të shquara të artit.⁶⁸

Për kriminelët e trafikeve të artit, dhe të pronës kulturore, trafikimi shërben si një produkt ideal i lëvizshëm, çmimi është subjektiv, mund të përdoret si financim ose kolateral, tregu është i parregulluar për nga natyra relativisht i lehtë për të fshehur dhe transportuar. Sistemi financiar global u mundëson kriminelëve që të blejnë vepra kulturore të palicencuar dhe të paligjshme në mënyrë anonime dhe keq-përdorimin e faturimin të tregtisë për t'iu shmangur taksave si dhe për tu pastruar. Kriminelët dhe terroristët kanë përfituar nga shitja me

⁶⁸ . Transnational Crime and the Developing World, 2016. Faq.69.

vlera të larta të veprave të çmuara kulturore, trafikimi i pronave kulturore si një mjet për financim të shpejtë, duke përfshirë edhe Luftën Civile në Siri etj.

3.5. Pastrimi i parave

Pastrimi i parave është termi i përgjithshëm i përdorur për të përshkruar procesin me të cilin kriminelët maskojnë pronësinë dhe kontrollin e të ardhurave të sjelljes kriminale duke i bërë të ardhurat e tilla të duket se kanë rrjedhur nga një burim legjitim. Skema e përgjithshme e këtij procesi i kthen paratë e keqpërdoruesit në një mënyrë të paqartë dhe indirekte në tregun legal. Një problem i veprimtarive kriminale është llogaritja e të ardhurave pa ngritur dyshimin e agjencive të zbatimit të ligjit. Keqpërdoruesit hargjojnë mund e energji për të futen në strategji e biznesit të tij parat e pastruara, më pas përdorimin e sigurt të atyre si të ardhura pa ngritur dyshimin. Zbatimi i strategjive të tilla zakonisht quhet pastrim parash. Pasi të jenë pastruar paratë, ato mund të përdoren për qëllime legjitime. Sipas zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin, vlerëson se "sasia e parave të pastruara globalisht për një vit është 2 deri 5% e GJDP-së globale, ose 800 bilion \$ dollarë amerikanë." Sulmet terroriste të 11 shtatorit në 2001 në SHBA, vuri në pah mos zbatimin e ligjit mbi pastrimin e parave, të cilat shumica derdhen në fondet për financimin e terrorizmit. Duke filluar nga viti 2002, qeveritë e shteteve të shumë vendeve në gjithë botën përmirësuan ligjet mbi pastrimin e parave dhe sistemet e mbikëqyrjes dhe monitorimit të transaksioneve financiare. Gjatë periudhës 2011–2015 një numër i madh bankash u përballën me gjobë në rritje, për shkelje të rregullave të pastrimit të parave. P.sh HSBC, u gjobit me 1.9 miliard dollarë në dhjetor 2012, dhe BNP Paribas, u gjobit me 8.9 miliardë dollarë në korrik të viti 2014. Shumë vende prezantuan strategjitë për luftimin e pastrimit të parave si dhe forcuan kontrollet kufitare mbi sasinë e parave të gatshme që mund të barten dhe futen në sistemet qendrore të raportimit të transaksioneve, të gjitha institucionet financiare duhet të raportojnë të gjitha transaksionet financiare në mënyrë elektronike.

3.5.1. Definicioni i pastrimit të parave

Pastrimi i parave është përpunimi i të ardhurave kriminale me qëllim maskimin e origjinës së tyre të paligjshme. Pastrimi i parave është procesi i paligjshëm i fshehjes së origjinës së parave të marra në mënyrë të antiligjore. Qëllimi kryesor i përdorimit të teknikave të pastrimit të parave është të sigurojë disponueshmërinë e fondeve të paligjshme në një kontekst tjetër që do të kishte qenë i padisponueshëm dhe të financojë ciklin e vazhdueshëm të

veprimtarisë ilegale të drogës, armëve, terrorizmit, lojërave të fatit etj.⁶⁹ Pastrimi i parave, në termat më të thjeshtë, është transferimi i parave të marra nga aktiviteti kriminal në kanale "legjitime" për të maskuar origjinën e tij të paligjshme.⁷⁰ Paratë e marra nga veprimtari të caktuara, të tilla si zhvatje, tregtim të brendshëm, korrupsioni, trafikimi me qenien njerëzore, drogë, armë, apo bixhozi të fituara në mënyrë të paligjshme në formë të ndyra ato duhet të "pastrohen" për t'u dukur se kanë bazë ligjore të veprimtarisë, në mënyrë që bankat dhe institucionet e tjera financiare mos ti marrin si para me dyshim.

3.6. Lufta kundër pastrimit të parave

Lufta kundër pastrimit të parave dhe konfiskimit të aseteve të fituara në mënyrë të kundërligjshme janë elementi kryesor në luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Përkushtimi dhe fokusi i institucioneve shtetërore, sistemit të drejtësisë në Kosovë si dhe në botë duhet të jenë të përqendruara në parandalimin, luftimin dhe trajtimin sa më efikas të kësaj veprimtarie kriminale. Mungesa e konfiskimit të aseteve të fituara në mënyrë të kundërligjshme, kryesisht përmes pastrimit të parave tregon mungesën e dëshirës, përkushtimit, këmbëngulësisë, profesionalizmit të institucioneve të sistemit të drejtësisë, Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe gjykatave në Kosovë. Mangësitë e PRSK-së (Prokuroria speciale e Kosovës) dhe gjykatave speciale për krime të rënda, në trajtimin e rasteve të pastrimit të parasë në Kosovë, ka ndikuar në përhapjen e këtij krimi.

3.7. Task Force e Veprimit Financiar (FATF)

Udhëzimet kundër pastrimit të parave venë në pah globalisht si rezultat i formimit të Task Force të Veprimit Financiar (FATF) dhe shpalljes së një kornize ligjore ndërkombëtare në fushën e standardeve të pastrimit të parave. Këto standarde filluan të marrin më shumë rëndësi në 2000 dhe 2001, pasi FATF filloi një proces për të identifikuar publikisht vendet që ishin të mangëta në ligjet e tyre kundër pastrimit të parave dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Udhëzimet FATF kundër pastrimit të parave kërkon nga shtetet që të bën:

- a.) Monitorimi i progresit të anëtarëve në zbatimin e masave të pastrimit të parave;

⁶⁹ . Bolaj, K.2010."Preventig Terrorism"; Good Governance or Collective Security?" *Journal of Sustainable*, 12 (1):207-222.

⁷⁰ . Moshi, Huphrey PB 2012., "Institutional Capacity of Combating Money Laundering". *Proceedings of Regional video conference on Anti-Money Laundering and Combating the Financing*.

- b.) Rishikimi dhe raportimi i tendencave, teknikave dhe masave të pastrimit, dhe
- c.) Promovimi, miratimi dhe zbatimi i standardeve të pastrimit të parave të FATF-it globalisht.

Për të zbatuar rregulloret e FATF, shtetet anëtare dhe institucionet e tyre financiare duhet të zbatojnë masa të verifikimit të ID-së së Klientit (KYC), të kryejnë masa të rekomanduara të kujdesit të duhur, të mbajnë shënime të përshtatshme për klientët me rrezik të lartë, të monitorojnë rregullisht llogaritë për aktivitetet e dyshuara financiar dhe të raportojnë mbi veprimtarinë e tyre autoritetet kombëtare, të vendosni sanksione efektive kundër personave juridikë dhe subjekteve të detyruara që nuk respektojnë rregullat e FATF.

3.8.1. Njësia e Inteligjencës Financiare të Kosovës

Çdo gjë që shitet duhet të ketë njësitin e inteligjencës financiare në kuadër të institucioneve të sigurisë, (Policinë për krime të rënda financiare). Njësia e Inteligjencës Financiare e Kosovës ka publikuar raportin mbi tipologjitë e pastrimit të parave të personave të ekspozuar politikisht. Përmes shembjeve dhe rasteve shumë konkrete pasqyron pastrimin e milionave eurove përmes bizneseve të ndryshme, kredive, investimeve në patundshmëri, por edhe transfereve të mjeteve nga shtete të ndryshme të botës.

3.8.2. Format e Pastrimit të parave

Veprimtaria kriminale e pastrimit të parave bënë pjesë në grupin e krimit të organizuara, është aktivitet kriminal i jashtëligjshëm i cili realizohet nga një strukturë organizative, e cila kryhet nga persona të cilët punojnë në punë grupore. Format më të përhapura të pastrimit të parave janë:

1. Vendosja përfshin vendosjen e produkteve të veprës penale në sistemin financiar.
2. Shtresëzimi përfshin konvertimin e të ardhurave nga krimi në një formë tjetër dhe krijimin e shtresave komplekse të transaksioneve financiare për të maskuar gjurmët e auditimit, burimin dhe pronësinë e fondeve. Kjo fazë mund të përfshijë transaksione të tilla si blerja dhe shitja e aksioneve, mallrave ose pronës.
3. Integrimi përfshin vendosjen e të ardhurave të pastruara përsëri në ekonomi për të krijuar perceptimin e legjitimitetit.⁷¹

⁷¹ . FATF (2006), *Trade-Based Money Laundering*, FATF, Paris, France.

3.8.3. Tre projektligje të Këshillit të Evropës

Tre projektligje të komisionit parlamentar të KE-së synojnë të mbyllin shtigjet e in formalitetit, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit janë;

1. “Projektligji për regjistrimin e biznesit”,

2. “Projektligji për procedurat tatimore”, dhe

3. “Projektligji për masat kundër financimit të terrorizmit” më të cilat synohet përmbushja e rekomandimeve dhe adresimin e problematikave të evidentuara në raportin e vlerësimit të Komitetit Moneyval të Këshillit të Evropës, për çështjet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

3.8.4. Metodatat e pastrimit të parave

Pastrimi i parave mund të marrë disa forma, shumica e metodave ndahen, kategorizohen në disa lloje. Këto përfshijnë "metodat bankare, mashtrimi (i njohur gjithashtu si strukturim), shkëmbimet e valutave dhe faturimi i dyfishtë".

1. **Strukturimi.**- Shpesh i njohur si mashtrim, është një metodë e vendosjes me anë të së cilës paraja është e ndarë në depozita më të vogla parash, e përdorur për të ulur dyshimin për pastrim dhe për të shmangur kërkesat e raportimit kundër pastrimit të parave.

2. **Kontrabanda me shumicë e parave të gatshme.**- është formë e kontrabandimit fizikisht të parave në një institucion financiar, bankat me fshehtësi më të madhe bankare.

3. **Bizneset me intensitet të parave të gatshme.**- Në këtë metodë, një biznes zakonisht pritet të marrë një pjesë të madhe të ardhurave të tij pasi paratë e përdorura llogariten të tij për të depozituar si para të gatshme. Në grupin e këtyre bizneseve bëjnë pjesë: parkingjet, klubet e zhveshjes, sallonet për rrezitje, larja e makinave, baret, restorantet dhe kazinot.

4. **Pastrimi i bazuar në tregti.**- Kjo metodë është një nga format më të reja dhe më komplekse të pastrimit të parave. Kjo përfshin fatura nën-ose mbi-vlerësuese për të maskuar lëvizjen e parave. P.sh. tregu i artit është vlera subjektive e veprave të artit si dhe fshehtësia e shtëpive të ankandëve në lidhje me identitetin e blerësit dhe shitësit.

5. **Rrokullisje e rrumbullakët.**- Këtu, paratë depozitohen në një korporatë të huaj të kontrolluar në det të hapur, ku mbahen regjistrime minimale, dhe pastaj dërgohen përsëri si një investim i drejtpërdrejtë, i liruar nga tatimi.

6. **Kapja e bankës.**- pastruesit e parave blejnë aksione në një bankë. **7. Kazinot;** **8. Kumar;** **9. Pagat e zeza;** **10. Pastrimi i transaksioneve;** **11. Paraja elektronike dixhitale.**

3.8.5. Roli i institucioneve financiare në parandalimin e pastrimit të parave

Bankat duhet të veprojnë përgjegjshëm në zbatimin e ligjit dhe rregullave kundër pastrimit të parave, institucionet financiare të gjitha të strukurojnë përpjekjet e tyre kundër pastrimit të parave. Të gjitha institucionet financiare në nivel global, dhe institucionet jofinanciare, janë të detyruara të identifikojnë dhe raportojnë transaksionet e një natyre të dyshimtë në njësinë e inteligjencës financiare të vendit përkatës. Për shembull, një bankë duhet të verifikojë identitetin e një klienti, nëse është e nevojshme të monitorojë transaksionet për një veprimtari të dyshimtë. Ky proces është nën masat "e diklientimit", që do të thotë të njohësh identitetin e klientit dhe të kuptoj llojet e transaksioneve në të cilat klienti ka të ngjarë të angazhohet. Punonjësit e bankës, si shitësit dhe përfaqësuesit e llogarive të klientëve, duhet të jenë të trajnuar në identifikimin e veprimtarisë së pastrimit të parave, obligohen të raportojnë aktivitete që i konsiderojnë të dyshimta. Softueri kundër pastrimit të parave filtron të dhënat e klientëve, i klasifikon ato sipas nivelit të dyshimt dhe inspekton atë për anomali. Anomali të tilla përfshijnë çdo rritje të papritur dhe të konsiderueshme të fondeve, një tërheqje të madhe ose transferimin e parave në juridiksionin e sekretit bankar.

3.8. Organizatat globale anti-krim

Shtetet anëtare të OKB-së janë të detyruara që të respektojnë konventat, instrumentet dhe standardet e ndryshme ndërkombëtare, të tilla si, Konventa e vitit 2000 kundër krimit të organizuar transnacional, Konventa e Kombeve të Bashkuara 2003 kundër Korrupsionit, dhe rekomandimet e Task Force e Veprimit Financiar për Pastrimin e Parave (1989) për të miratuar dhe zbatuar ligje për pastrimin e parave në një përpjekje për të ndaluar trafikimin e narkotikëve, krimin e organizuar ndërkombëtar dhe korrupsionin. Task Force për Veprimin Financiar për Pastrimin e Parave (FATF) e formuar në vitin 1989, është një organ ndërqeveritar qëllimi i të cilit është të zhvillojë dhe promovojë një reagim ndërkombëtar për të luftuar pastrimin e parave. FATF aktualisht përfshin 34 anëtarë dhe 2 organizata rajonale, që përfaqësojnë qendrat më të mëdha financiare në të gjitha pjesët e globit.

3.10. Rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar në intensifikimin e luftës së pastrimit të parave

Së pari, vendet të intensifikojnë luftën kundër korrupsionit dhe evazionit fiskal. Sipas analizave theksohet qartë se korrupsioni sistematik mund të dëmtojë seriozisht aftësinë e një vendi për të ofruar rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Evazioni fiskal në shkallë të

gjerë është gjithashtu problematik, sepse zakonisht do të thotë me pak investime në shëndetësi, arsim dhe shërbime të tjera publike.

Së dyti, duhet të promovohen mënyra më efektive për të luftuar financimin e terrorizmit. Kjo nënkupton ndërtimin e përvojave për të zhvilluar një kornizë për zbatimin e sanksioneve financiare të synuara. Qeveritë duhet të shfrytëzojnë gjithnjë e më shumë fuqinë e teknologjisë financiare.

Së treti, ekonomitë e vogla dhe të brishta duhet të ndihmohen të kenë akses në shërbimet bankare që i lidhin ato me sistemin financiar global.

3.11. Mallra të falsifikuara dhe pirateria

Tregtia e mallrave të falsifikuara dhe pirateria është tregtia e paligjshme me vlerë të ekzaminuar nga 923 miliardë dollarë amerikanë deri 1.13 trilion dollarë në vit. Përafërsisht 2/3 deri në 3/4 e mallrave të falsifikuara dhe mallrave të piratuar vijnë nga Kina. Falsifikimi farmaceutikë përbën nga 10% deri në 30% të ilaçeve të disponueshme. Vlera vjetore e falsifikimit të farmaceutikëve vlerësohet nga 70 miliardë dollarë deri në 200 miliardë \$ në vit. Ushqimi i falsifikuar dhe ilaçet e padobishme ose të falsifikuara rrezikojnë shëndetin dhe sigurinë e publikut. Në vitin 2016, importet e produkteve të falsifikuara dhe pirate në BE arritën në 121 miliardë euro (134 miliardë \$), të cilat përfaqësojnë deri në 6.8% të importeve të BE, kundrejt 5% të eksporteve të BE në vitin 2013.⁷²

Përbërësi	Vlera \$
Tregtia ndërkombëtare e mallrave të falsifikuara dhe pirate	461 miliardë \$
Tregtia e brendshme e mallrave të falsifikuara dhe pirate	249 miliardë \$ deri ne \$ 456 miliardë \$
Totali:	710 miliardë \$ deri ne \$917 miliardë \$. ⁷³

Tabela 11. Tregtia me mallra të falsifikuar dhe pirateria, 2017 (US \$)

Në studim është analizuar vlerat globale të mallrave praktikisht digjitale, siç janë filmat, muzika dhe softuer, kanë gjeneruar vlerë prej 213 miliardë dollarë amerikane. Pirateria e filmit digjital 160 miliardë \$ amerikanë, ndërsa muzika dhe programet digjitale 29 miliardë \$

⁷² . <http://www.oecd.org>.

⁷³ . Burimi: Frontier Economy, 2016.

amerikane. Pirateria e filmit digjital 160 miliardë \$ amerikanë, ndërsa muzika dhe programet digjital 29 miliardë \$ amerikanë.⁷⁴

Përbërësi	Vlera \$
Film	\$160 miliardë
Muzike	\$29 miliardë
Softuerë	\$24 miliardë
Total:	\$213 miliardë

Tabela 12. Tregtia e mallrave me pirat digjital, 2015 (US-\$)⁷⁵

3.12. Tregtia e paligjshme e jetës së egër

Sipas hulumtimeve tregtia e paligjshme e jetës së egër përfshin vlerën vjetore të shitjes me pakicë nga 5 miliardë deri 23 miliardë \$. Bri i fildishtë dhe Rhino janë dy nga komponentët më të mëdhenjtë të vlerës së tregut dhe marrin më shumë vëmendjen e publikut, megjithatë pangolina është në të vërtetë kafsha më e trafikuar në botë. Tregtia e paligjshme e jetës së egër mbështetet në një zinxhir global të sofistikuar të furnizimit, i drejtuar nga grupe të krimit të organizuar të financuar mirë. Në vendet në zhvillim trafikimi i kafshëve të egra u plaçkit bashkësive të ardhurave të cilat njëkohësisht ka ndikime të dëmshme mbi mjedisin, sigurinë dhe sundimin e ligjit, ndërkaq fitimi i realizuar nuk i takon ekonomisë së vendit.⁷⁶

Artikulli	Çmimi
Papagall gri Afrikan	\$2,000
Elefanti i ngadaltë	\$5,000
Elefant për fëmijë (Tajlandë)	\$7,000
Gorilla	\$400,000
Ekstrakt arushë i papërpunuar (për gram)	\$19
Luspa Pangolinë	\$1,750
Ngjitë kockash tigri (për një kilogram, Hanoi)	\$10,000

Tabela 13. Shembull i çmimeve të tregut me pakicë-Online (US \$)

3.13 Peshkimi i paligjshëm, i pa raportuar dhe i parregulluar (IUU)

Peshkimi i paligjshëm, i pa raportuar dhe i parregulluar mbetet një nga kërcënimet më të mëdha për ekosistemet detare për shkak të aftësisë së tij të fuqishme për të minuar përpjekjet

⁷⁴ . Organisation for Economic Co-operation and Development and European Union Intellectual Property Office, *Trade in Counterfeit and Pirated Goods: Mapping the Economic Impact* (Paris: OECD Publishing Office, 2016), 16, <http://www.oecd.org/gov/risk/trade-in-counterfeit-and-pirated-goods-9789264252653-en.htm>.

⁷⁵ .Frontier Economics, *The Economic Impacts of Counterfeiting and Piracy* (London: Frontier Economics, 2017), 57, http://www.inta.org/Communications/Documents/2017_Frontier_Report.pdf.

⁷⁶ . <http://www.oecd.org>

kombëtare dhe rajonale për të menaxhuar peshkimin në mënyrë të qëndrueshme, si dhe përpjekjet për të ruajtur biodiversitetin detar. Peshkimi i paligjshëm, i pa raportuar mund të shoqërohet me krim të organizuar. Produktet që rrjedhin nga peshkimi ilegal, i paligjshëm mund të gjejnë rrugën e tyre në tregjet e tregtisë jashtë shtetit, duke varfëruar furnizimin me ushqime komunitetin lokal. Prandaj, peshkimi ilegal, i paligjshëm kërcënon jetesën, përkeqëson varfërinë dhe rrit pasigurinë ushqimore.⁷⁷

3.12.Kyçje ilegale

Kyçjet ilegale vlerësohen të fitimi ilegal, informal, kriminal, nga i cili vlera e fitimit varion nga 52 miliardë \$ deri në 157 miliardë \$ në vit; kjo e bënë këtë lloj të krimit të dobishëm për kriminelet e burimeve natyrore. Druri dhe produktet e tij të tregtuar në mënyrë të paligjshme përbën 10% deri në 30 % të tregtisë totale globale, ky lloj i krimit ndodh kryesisht në Azinë Juglindore, Afrikën Qendrore dhe Amerikën e Jugut, ku rreth 50% deri 90 % e drurit nga këto rajone është tregtuar në mënyrë të paligjshme. Kina konsiderohet destinacioni kryesor për shumicën e lëndës drunore me burim të paligjshëm.⁷⁸ Edhe kyçjet ilegale janë veprimtari të paligjshme, të ndaluara, të dënueshme, nga i cili përfitojnë në mënyrë të paligjshme konsumatorët e pandërgjegjshëm.

3.13.Minierat e paligjshme

Sipas raportit të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin si dhe sipas INTERPOL-it eksploatimi i paligjshëm ilegal dhe tregtimi i mineraleve të minierave anekënd botës gjenerojnë fitime nga 12 miliardë \$ deri në 48 miliardë \$ në vit. Minierat e paligjshme ndodhen kryesisht në vendet në zhvillim. Ekspertët vlerësojnë se eksploatimi i paligjshëm i mineralit të arit në nëntë vende të Amerikës Latine varion nga afërsisht 7 miliardë deri 10 miliardë \$ amerikanë çdo vit. Diamantet në përgjithësi mendohet se përfaqësojnë më pak se një përqindje të prodhimit global, megjithatë diamantet e eksploatuar në mënyrë të paligjshme vlerësohet se përbëjnë 20 % të prodhimit në të gjithë botën përafërsisht 2.74 miliardë \$ amerikanë në vitin

⁷⁷. United Nations Office on Drugs and Crime, *Transnational Organized Crime in the Fishing Industry* (Vienna: United Nations Office on Drugs and Crime), 25, https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/Issue_Paper_-_TOC_in_the_Fishing_Industry.pdf.

⁷⁸. Food and Agriculture Organization of the United Nations, *FAO Yearbook of Forest Products 2014*, FAO Forestry Series No. 49 (Rome: Food and Agriculture Organization of the United Nations, 2016), 226.

2015. Shfrytëzimi i burimeve natyrore përbën një burim të rëndësishëm të financimit për grupet e krimit të organizuar, organizatat terroriste dhe grupet kryengritëse.⁷⁹

3.14. Vjedhja e naftës së papërpunuar

Vjedhja e naftës së papërpunuar vlerësohet të jetë nga 5.2 miliardë \$ deri në 11,9 miliardë \$ amerikanë në vit. Vlera e vjedhjes së naftës bruto në të gjithë botën është e lidhur drejtpërdrejtë me vëllimet e prodhimit dhe çmimet e tregut botëror për vaj. Kur çmimet e naftës ishin mesatarisht 100 dollarë amerikanë ose më shumë për fuçi, vjedhja e naftës u vlerësua shumë më e lartë; për shembull, në Nigeri vlerësohej të ishte me vlerë 12 miliardë dollarë amerikanë në vit. Vjedhja e naftës së papërpunuar vlerësohet të ketë vlerë të paktën 5.2 miliardë dollarë deri në 11,9 miliardë dollarë në vit. Vjedhja e naftës bruto ndodh në çdo vend të botës ku prodhohet nafta, megjithatë këto gjashtë vendet konsiderohen si vende me nivelin më të lartë të vjedhjes së naftës së papërpunuar.⁸⁰

⁷⁹ . http://unep.org/documents/itw/environmental_crimes.pdf.

⁸⁰ . An estimated 35 billion barrels for 2016. “Oil,” *International Energy Agency*, accessed November 29, 2016, <https://www.iea.org/about/faqs/oil/>.

Kapitulli IV

4. Krimi i organizuar në Kosovë

4.1. Trafikimi më lende narkotike

Sikur në vendet e tjera të botës as Kosova nuk është imun nga krimi i organizuar, përkundrazi viteve të fundit edhe në Kosovë krimi i organizuar është në ekspansion. Trafikimi me lëndë narkotike është një nga krimet që vazhdon të mbetet ndër format më të theksuara të përfshirjes së grupeve të organizuara kriminale në Republikën e Kosovës. Sipas vlerësimeve të agjencive dhe organizatat ndërkombëtare që merren me vlerësimin e organizimit e krimi të organizuar në përgjithësi dhe trafikimit me lëndë narkotike në veçanti, Kosovën e konsiderojnë si një ndër rrugët më të rëndësishme të trafikut ndërkombëtar të substancave narkotike të llojit heroinë, si edhe në njërin ndër rrugët e trafikut ndërkombëtar të substancave tjera si mariuhanë e kokainë. Këto vlerësime nuk janë të bazuara në të dhëna zyrtare të Institucioneve të Kosovës, por janë siguruar në forma të ndryshme, duke përfshirë raportimet e vendeve fqinje apo edhe raportimet individuale nga zyrtarë të misioneve ndërkombëtare në Kosovë. Raportet zyrtare mbi konfiskimin e lëndëve narkotike përgjatë kufijve dhe në brendësi të territorit të Kosovës, me përjashtim të mariuhanës, kanë qenë kryesisht në sasi relativisht të vogla, duke mos kaluar sasinë më tepër se 10 kg për një dërgesë. Duke marrë parasysh pozitën gjeografike, Kosova nuk përbën të ashtuquajturën rrugë ballkanike të trafikimit të drogës, pasi që nuk është vendi i parë, por as i fundit që ndërlidh rrugët e trafikut mes ofertës dhe kërkesës në mes të Azisë dhe Lindjes së mesme për vendet e Evropës Perëndimore. Sasia e lëndëve narkotike që kalon përmes Kosovës e që është e destinuar për tregun e Evropës Perëndimore, kryesisht është në sasi më të vogla, ndërsa transporti i saj kryesisht bëhet me vetura private, duke shfrytëzuar diasporën Kosovare në vendet e Evropës Perëndimore, të cilët vizitojnë shpesh Kosovën. Megjithatë duke marrë parasysh kapacitetet e kufizuara të Kosovës për prodhimin e mallrave me qëllim të eksportit, mungesën e kompanive për transportimin e mallrave, apo edhe vështirësitë që kanë qytetarët e Kosovës për të lëvizur lirshëm për në vendet e BE-së, Kosova gjithnjë e më pak shihet si një vend atraktiv me qëllim të trafikimit të lëndëve narkotike përmes territorit të saj. Bazuar në të dhënat zyrtare të institucioneve të sigurisë në Kosovë viteve të fundit është shënuar një rënie e sasisë së lëndëve narkotike, posaçërisht të heroinës, ndërsa që nga viti 2014 vërehet rënie edhe në sasinë e mariuhanës, e cila ndërlidhet me operacionet e fundit të ndërmarra nga autoritetet shqiptare për asgjësimin e parcelave (sipërfaqeve, tokave) në të cilat kultivohej kanabisi.

Lloji i drogës	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015
Marihuana	1238kg	581kg	738kg	462kg
Heroina	94.1kg	22.4 kg	9.6 kg	9.6kg
Kokaina	7.4kg	3.3 kg	21.1 kg	0.054 kg
Ekstazë	153	107	52	266
Bimë Kanabis	10584	1512	6930	1557
Fara Kanabisi	12508	1024	5165	141

Tabela 14. Konfiskimet nga Policia e Kosovës për gjatë viteve 2012 – 2015.⁸¹

Gjatë vitit 2014 në krahasim me vitet paraprake është shënuar rritje e konsiderueshme e konfiskimit të lëndës narkotike të llojit kokainë, por e cila nuk mund të merret si indikator i prezencës më të madhe të kësaj lënde narkotike në tregun kriminal, pasi që pothuajse e tërë sasia e konfiskuar është bërë gjatë një operacioni të përbashkët me autoritetet shqiptare. Sipas të dhënave nga Organizata joqeveritare “Labyrinth” e cila merret me trajtimin e personave të varur nga lëndët narkotike, në këtë qendër që nga viti 2002 janë trajtuar gjithsej 1084 persona, dominojnë përdoruesit e lëndëve narkotike mariuhanë, heroinë dhe kokainë dhe nuk është regjistruar ndonjë rast i trajtimit nga llojet e drogave sintetike. Duke marrë parasysh raportet e Policisë së Kosovës, përkatësisht nga Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Lëndë Narkotike, ofrojnë të dhëna mbi sasinë e konfiskimit të lëndëve narkotike dhe personave të arrestuar, por që nuk ofrojnë vlerësim apo analizë të detajuar mbi ndarjen e saktë të sasisë apo llojit të drogës të destinuar për tregun e jashtëm apo edhe asaj të destinuar për tregun e brendshëm. Vlerësuar në përgjithësi Kosova ka bazë të mjaftueshme ligjore për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me lëndë narkotike, duke tentuar që të përfshihen të gjitha Konventat e rëndësishme ndërkombëtare që kanë të bëjnë me narkotikët, duke përfshirë Kodin Penal, i cili me ndryshimet që janë bërë në vitin 2013 veprat penale që ndërlidhen me narkotikët i ka përfshirë në një kapitull të veçantë, duke ashpërsuar në të njëjtën kohë edhe sanksionet penale. Ligj tjetër i rëndësishëm është Ligji mbi Barërat Narkotike, substancat psikotrope përmes të cilit ligj rregullohet çështja e përdorimit edhe të barërave narkotike, ku përveç pjesës përshkruese përmban edhe listën e barërave narkotike, prekursorëve dhe substancave psikotrope. Megjithatë zhvillimet në nivel global mbi identifikimin e substancave të reja të cilat si të vetme nuk janë të përfshira në këto lista, me përzierje me ndonjë substancë tjetër formojnë substanca të rrezikshme, është ngritur nevoja për ndryshime e këti ligj, me theks të veçantë të azhurnimit

⁸¹ . Vlerësimi i kërcënimit nga krimet e rënda dhe krimi i organizuar – SOCTA, faq. 13, *Prishtinë, Prill, 2016*.

të këtyre listave.⁸² Po ashtu ka ngecje edhe në menaxhimin e metadonit, që përdoret për trajtimin e këtyre personave.⁸³

Institucionet e Kosovës vazhdojnë të ballafaqohen me sfida të shumta sa i përket parandalimit dhe luftimit të trafikimit me lëndë narkotike, duke filluar nga nevoja e ndryshimit të ligjit mbi barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorët, pastaj mungesa e koordinimit të mirëfilltë të aktiviteteve ndërinstucionale. Vështirësitë më të mëdha hasen në fushën e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, pasi që Kosova përveç disa marrëveshjeve bilaterale të bashkëpunimit me disa vende fqinje dhe më gjerë, nuk është e anëtarësuar në asnjë nga institucionet rajonale apo ndërkombëtare policore.⁸⁴

a.) Problemi me përdorimin e lëndëve narkotike

Në Kosovë ka mungesë të një baze gjithëpërfshirëse së të dhënave mbi numrin e përdoruesve apo abuzuesve të lëndëve narkotike, mirëpo në bazë të disa të dhënave joformale nga organizata të ndryshme joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare numri i përdoruesve apo abuzuesve të lëndëve narkotike sillet prej 15.000 – 30.000 persona, shprehur në përqindje me numrin e përgjithshëm të popullatës të Kosovë përdoruesit e drogave përbejnë 0.8% - 1.6%, ndersa 0.27% - 0.33% vlerësohet të jenë përdorues të drogave në mënyrë intravenoze.⁸⁵

b. Marihuana

Sasia më e madhe e marihana në Kosovë hyn nga Shqipëria, kurse një sasi më e vogël edhe nga Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi. Një pjesë e marihanës ndalet në Kosovë për konsum të brendshëm ndërsa pjesa tjetër e cila konsiderohet disa herë më e madhe kalon transit drejt vendeve tjera, kryesisht drejt tregut të Evropës Perëndimore. Gjatë vitit 2014 janë identifikuar 19 parcela të mbirjes së egër ose kultivuara me gjithsej 3724 bimë kanabis dhe 39 parcela të kultivimit të kanabisit nga persona të dyshuar me gjithsej 3206 bimë. Ndër rajonet ku janë regjistruar parcelat më të shumta të kultivimit të kanabisit janë gjetur në rajonin e Mitrovicës dhe Pejës dhe kryesisht në zona të thella rurale, identifikimi është mjaft i vështirë dhe në raste të caktuara mund të identifikohen vetëm në bazë të informacioneve paraprake për ekzistencën e këtyre plantacioneve.⁸⁶ Në tabelën janë të paraqitura konfiskimet e marihanës dhe

⁸² . Bazuar në bisedën që është zhvilluar më zyrtarët e laboratorit të forenzikës, në tregun Kosovar mund të gjenden substanca të shumta të cilat në rast të përzierjes me ndonjë substancë tjetër kimike mund të krijohen substanca psikotrope mjaft të rrezikshme.

⁸³ . Vlerësimi i kërcënimit nga krimet e rënda dhe krimi i organizuar – SOCTA, faq. 17, *Prishtinë, Prill, 2016*.

⁸⁴ .Po aty, 17

⁸⁵ . Bazuar në të dhënat nga OJQ Labyrinth, 2017.

⁸⁶ . Vlerësimi i kërcënimit nga krimet e rënda dhe krimi i organizuar – SOCTA, faq. 19, *Prishtinë, Prill, 2016*.

shkatërrimit të bimëve të kanabisit të cilat janë kultivuar në plantacione të ndryshme brenda territorit të Kosovës.⁸⁷

c. Heroina

Sipas të dhënave policore mbi konfiskimin e lëndëve narkotike në Kosovë, nga viti 2013 dhe veçanërisht nga viti 2014 vërehet një rënie drastike e sasisë së heroinës së konfiskuar, e cila ndërlihet drejtpërsëdrejti edhe me mungesën e kësaj lënde narkotike në tregun Evropian, por edhe më gjerë. Ndër faktorët kryesorë të mungesës të heroinës në tregun Evropian vlerësohet të jenë trazirat dhe konfliktet në vendet e lindjes së mesme, si në Irak dhe Siri, vende të cilat kanë luajtur rol të rëndësishëm në trafikimin e kësaj lënde apo edhe lëndës së parë të Heroinës nga Afganistani, si burim kryesor i prodhimit të Opiumit për në Turqi, prej nga pastaj përmes rrugëve të ndryshme tokësore, duke përfshirë edhe transitin përmes rrugëve taksorë dhe detare të Ballkanit bëhet transportimi i saj për në vendet e Evropës. Kjo situatë ka ndikuar që grupet e organizuara kriminale ndërkombëtare të vihen në kërkim të rrugëve dhe tregjeve alternative. Edhe pse nuk ekzistojnë të dhëna të sakta, ekziston dyshimi i bazuar që grupet e organizuara kriminale ndërkombëtare në bashkëpunim me grupet e ndryshme ekstremiste dhe terroriste janë të përfshira në trafikimin e heroinës, duke ngritur dyshimin se një pjesë e profitit nga kjo veprimtari kriminale vihet në dispozicion të financimit të aktiviteteve të grupeve ekstremiste dhe atyre terroriste.⁸⁸ Ky bashkë dyzim i aktiviteteve në mes të grupeve të organizuara kriminale dhe atyre ekstremiste e terroriste, si pasojë e disproporcionit në mes të kërkesës e ofertës ka ndikuar në ngritjen e çmimit të heroinës në përgjithësi në tregun Evropian, duke përfshirë edhe rritjen e çmimit të saj edhe në Kosovë. Sipas vlerësimeve të agjencive dhe organizatat ndërkombëtare që merren me vlerësimin e krimit të organizuar në përgjithësi dhe trafikimit me lëndë narkotike në veçanti, apo edhe vlerësimeve nga burimet e hapura është llogaritur që Kosova gjendet në një rëndësi të rëndësishme të trafikut ndërkombëtar të substancave narkotike të llojit heroinë, por edhe në një rëndësi të rëndësishme të trafikut ndërkombëtar të substancave tjera si marihuana e kokaina.⁸⁹ Transporti i heroinës përmes Kosovës kryesisht bëhet me vetura private, agjencitë turistike, duke shfrytëzuar diasporën Kosovare në vendet e Evropës Perëndimore, të cilët vizitojnë shpesh Kosovën. Nga organet e ndjekjes janë

⁸⁷ . Vlerësimi i kërcënimit nga krimet e rënda dhe krimi i organizuar – SOCTA, faq. 20, Prishtinë, Prill, 2016.

⁸⁸ . Vlerësimi i kërcënimit nga krimet e rënda dhe krimi i organizuar – SOCTA, faq. 120, Prishtinë, Prill, 2016.

⁸⁹ . Vlerësimi i kërcënimit nga krimet e rënda dhe krimi i organizuar – SOCTA, faq. 21, Prishtinë, Prill, 2016.

identifikuar grupe të vogla, aktivitetet e të cilave ka qenë kryesisht në transportin e heroinës për në Kosovë, dhe pastaj nga Kosova për në vendet e Evropës Perëndimore. Rezultatet hetimore ndaj këtyre personave apo grupeve të vogla, pengesë dhe vështirësitë për institucione në trajtimin e këtyre rasteve, paraqet mos anëtarësimin e institucionve të sigurisë së Kosovës me institucionet gjegjëse në nivel rajonal dhe global, hetimet nuk kanë rezultuar në analizimin e plotë të aktiviteteve dhe strukturës së mundshme të këtyre grupeve të organizuara kriminale.⁹⁰ Aktualisht çmimi për një kilogram heroinë sillet nga 17.000 - 22.000 Euro, varësisht nga cilësia, ndërsa çmimi për një dozë rreth 0.6 gram sillet nga 20-25 Euro.⁹¹

LLOJI DROGËS	2012	2013	2014	2015	2019
Marihuan	1238 kg	581kg	738kg	462kg	717.9 gr
Heroina	94.1 kg	22.4kg	9.6kg	9.6kg	9.803.65 gr
Kokaina	7.4kg	3.3kg	21.1 kg	0.054gr	2.676.85gr
Ekstazët	153k	107	52	265	225.42
Bimë Kanabis	10584	1512	6930	2575	5622 bimë
Fara Kanabis	12508	1024	5165	141	/

Tabelari.nr.15 Raporti vjetor i Policisë së Kosovës 2019

Në fushën e parandalimit, hetimit dhe zbulimit të trafikimit me narkotikë gjatë viti 2019: gjithsej është punuar në 1450 raste, janë realizuar 1014 operacione, janë neutralizuar 15 grupe kriminale, janë hetuar 1768 persona të dyshuar, janë arrestuar 1625 persona, janë paraqitur 1363 kallëzime penale ndaj 1641 personave. Janë konfiskuar: 7 kg e 718 gr. heroinë; 1 kg 581.68 gr. kokainë; 824 kg. e 230gr.marihuanë, 25 kg e 447g hashash, 6810 copë bimë kanabis dhe substanca tjera narkotike.⁹²Në fushën e parandalimit, hetimit dhe zbulimit të trafikimit me narkotikë gjatë vitit 2020 janë iniciuar gjithsej 1,005 raste të reja, janë arrestuar 1,144 persona dhe janë përcjellë 714 kallëzime penale ndaj 938 të dyshuarve. Prej tyre, për: (a) trafikim janë regjistruar 170 raste, janë arrestuar 276 persona dhe janë ngritur 185 kallëzime penale ndaj 284 personave të dyshuar; (b) posedim të drogave janë regjistruar 802 raste, janë arrestuar 847 persona të dyshuar dhe janë ngritur 508 kallëzime penale ndaj 633 personave të dyshuar; (c) kultivim janë regjistruar 33 raste, janë arrestuar 21 persona të dyshuar dhe janë ngritur 21 kallëzime penale ndaj 21 personave të dyshuar dhe 1 rast është iniciuar për droga të

⁹⁰ .Po aty, 22.

⁹¹ . Vlerësimi i kërcënimit nga krimet e rënda dhe krimi i organizuar – SOCTA, faq. 22, Prishtinë, Prill, 2016.

⁹² . Tabelari.nr.12 Raporti vjetor 2019, faq 11

tjera. Nga numri i përgjithshëm i rasteve, për heroinë janë iniciuar 37 raste dhe janë arrestuar 48 persona, për kokainë janë regjistruar 38 raste dhe janë arrestuar 70 persona, për mariuhanë janë iniciuar 898 raste dhe janë arrestuar 1,005 persona, ndërsa janë iniciuar 33 raste dhe janë arrestuar 21 persona për kultivimin e bimëve të kanabisit. Janë konfiskuar: 9 kg. 803.65 g heroinë; 2 kg. 676.85 gr. kokainë; 225.42 gr. ekstazë; 256 kg 717.9 gr marihuanë, 5622 bimë kanabis.⁹³

LLOJI I DROGËS	2012	2013	2014	1015	2020
Marihuan	1238 kg	581kg	738kg	462kg	717.9 gr
Heroina	94.1 kg	22.4kg	9.6kg	9.6kg	9. 803.65 gr
Kokaina	7.4kg	3.3kg	21.1 kg	0.054gr	2.676.85gr
Ekstazët	153k	107	52	265	225.42
Bimë Kanabis	10584	1512	6930	2575	5622 bimë
Fara Kanabis	12508	1024	5165	141	/

Tabelari.nr.16 Raporti vjetor i Policisë së Kosovës 2020.

Bazuar në Raportin e Policisë së Kosovës gjatë viteve 2019/20 vërehet një rënje e lehtë në fushën e krimit të organizuar në Kosovë(trafikimit me lëndë narkotike) gjatë kësaj periudhe kohore, rënja duket si ka ndodhur për shkak se Policia e Kosovës(organel e sigurisë) ishin agjil në luftimin e veprimtarisë kriminale të trafikanteve, apo ndoshta edhe për shkak të ndikimit të Pandemisë Covid 19 sipas gjasave pandemia i ka penguar kriminelet në veprimtarin e tyre.

4.2. Trafikimi me njerëz në Kosovë

Në periudhën e pas luftës, grupet e organizuara kriminale nga Kosova dhe vendet fqinje, edhe më gjerë, kanë përfituar nga fakti që legjislacioni i adoptuar nga administrata e UNMIK-ut nuk parashihte trafikimin e qenieve njerëzore si vepër penale (me përjashtim të prostitucionit e cila parashihej vetëm si kundërvajtje) kanë sjellë në Kosovë një numër të konsiderueshëm të viktimave të trafikuar me qëllim të shfrytëzimit seksual. Nuk ka informacione të mjaftueshme mbi mënyrën e trafikimit të këtyre viktimave dhe mënyrën e transportimit të tyre deri në Kosovë, mirëpo të njëjtat kryesisht vendoseshin në dispozicion të klubeve dhe lokaleve të natës, të cilat ishin mjaft të përhapura pothuajse në të gjitha rajonet e Kosovës, të cilat regjistroheshin si punëtoare apo valltare në këto lokale, mirëpo në të njëjtën kohë detyroheshin

⁹³. Tabelari.nr.15 Raporti vjetor i Policisë të Kosovës, 2020, faq.11


të ofronin edhe shërbime seksuale për klientët e këtyre lokaleve. Legjislacioni i Kosovës në aspektin e sanksionimit të veprës kriminale, trafikim me njerëz, është avancuar vazhdimisht, Kodi Penal i Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2013 është në përputhje me Konventën Ndërkombëtare të OKB-së për luftimin e krimit të organizuar, si dhe në Protokollin e Palermos për Trafikimin e Qenieve Njerëzore të vitit 2000. Sipas Kodit Penal të Kosovës termi "trafikim me njerëz" do të thotë rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pritja e personave me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, abuzimit me pushtetin ose abuzimit të pozitës së ndjeshme ose i dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi.⁹⁴

Raporti 2012-2015	2012	2013	2014	2015
Trafikimi me njerëz	34	38	28	24
Mundësi Prostitucioni	28	18	24	23
Veprat te tjera te trafikimit me njerëz	38	15	21	18

Tabela 17. Numri i rasteve që ndërlihen me veprat penale të trafikimit me njerëz gjatë viteve 2012 – 2015.

95

Bazuar në statistikat e paraqitura në tabelën nr.16 vërehet një rënie e lehtë e vazhdueshme e rasteve të trafikimit me njerëz. Gjithashtu edhe statistikat e veprave tjera penale që ndërlihen me natyrën e kësaj vepre penale numri i rasteve është relativisht e njëjtë.⁹⁶



Grafkoni 4 - Viktimat e Trafikimit sipas grup-moshave 2012-2015. ⁹⁷

⁹⁴ . Vlerësimi i kërcënimit nga krimet e rënda dhe krimi i organizuar– SOCTA, faq. 23, Prishtinë, Prill, 2016.

⁹⁵ . Po aty faq. 24.

⁹⁶ . Po aty, 25,

⁹⁷ . Vlerësimi i kërcënimit nga krimet e rënda dhe krimi i organizuar– SOCTA, faq. 26, Prishtinë, Prill, 2016.

4.3. Strategjia kombëtare kundër trafikimit me njerëz në Kosovë

Strategjia kombëtare kundër trafikimit me njerëz në Kosovë 2015-2019 fuqizon përpjekjet institucionale dhe të tërë shoqërisë Kosovare në parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz. Gjithmonë duke marrë parasysh rekomandimet që dalin nga raportet e organizatave ndërkombëtare, raportet e Komisionit Evropian si dhe partnerëve vendor dhe ndërkombëtar nga sektori privat dhe shoqërisë civile, me qëllim dhe synim të përbashkët, parandalimin, luftimin dhe çrënjosjen e fenomeneve kriminale si ato të trafikimit me njerëz. Strategjia kombëtare dhe Plani i Veprimit kundër Trafikimit me Njerëz në Kosovë reflekton objektivat strategjike në përputhje të plotë me Strategjinë e BE-së për ç ‘rënjosjen e Trafikimit me njerëz 2012-2016 dhe me adresim të problematikës në kontekst vendor dhe rajonal.⁹⁸

Në fushën e luftimit të trafikimit me qenie njerëzore, gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 64 raste, janë arrestuar gjithsej 104 persona të dyshuar dhe janë përcjellë në prokurori e gjykatë 37 kallëzime penale ndaj 88 personave të dyshuar dhe 17 fletëparaqitje për kundërvajtje ndaj 38 personave. Prej tyre, për: (a) trafikim me njerëz janë regjistruar 20 raste, janë arrestuar 12 persona të dyshuar dhe janë ngritur 8 kallëzime penale ndaj 13 personave të përfshirë; (b) mundësim prostitucioni janë iniciuar 11 raste, janë arrestuar 32 persona të dyshuar dhe janë ngritur 12 kallëzime penale ndaj 39 personave; (c) marrje me prostitucion janë regjistruar 17 raste, janë arrestuar 36 persona dhe janë përcjellë 17 fletëparaqitje për kundërvajtje ndaj 38 personave; (d) shërbime seksuale të viktimës së trafikimit dhe vepra të tjera të kësaj natyre janë regjistruar 16 raste, janë arrestuar 24 persona të dyshuar dhe janë ngritur 17 kallëzime penale ndaj 26 personave të përfshirë. Janë identifikuar 17 viktima dhe janë strehuar 8 viktima të trafikimit. Në kuadër të kampanjës së vetëdijesimit me moton “Mos hesht, ndal trafikimin me njerëz”, Policia ka realizuar planin operativ ‘Vjeshta 2020’ në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Gjatë operacionit janë kontrolluar 17 lokale dhe 133 persona. Nga inspektorët komunalë janë mbyllur 3 lokale dhe janë shqiptuar gjoba dhe vërejtje për mungesë të dokumentacionit të punës.⁹⁹

4.3. Migrimi Ilegal

Strategjia kombëtare kundër trafikimit me njerëz në Kosovë 2015-2019 fuqizon përpjekjet institucionale dhe të tërë shoqërisë Kosovare në parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz. Gjithmonë duke marrë parasysh rekomandimet që dalin nga raportet e

⁹⁸ . Po aty faqe, 31.

⁹⁹ . Tabelari.nr.15 Raporti vjetor i Policisë së Kosovës për vitin 2019, faq.11

organizatave ndërkombëtare, raportet e Komisionit Evropian si dhe partnerëve vendor dhe ndërkombëtar nga sektori privat dhe shoqërisë civile, me qëllim dhe synim të përbashkët, parandalimin, luftimin dhe çrrënjosjen e fenomeneve kriminale si ato të trafikimit me njerëz. Strategjia kombëtare dhe Plani i Veprimit kundër Trafikimit me Njerëz në Kosovë reflekton objektivat strategjike në përputhje të plotë me Strategjinë e BE-së për çrrënjosjen e Trafikimit me njerëz 2012-2016 dhe me adresim të problematikës në kontekst vendor dhe rajonal.¹⁰⁰

4.4. Migrimi ilegal


Migrimi i kategorive të caktuara të qytetarëve kosovarë drejt vendeve të Evropës Perëndimore është një dukuri e pranishme, me ngritjet dhe rëniet e veta dhe paraqet shqetësim të vazhdueshëm për institucionet vendore dhe ndërkombëtare si dhe për shoqërinë. Emigrantët kosovarë, janë kryesisht persona me gjendje të dobët ekonomike, të papunë ose të punësuar kryesisht në sektorin privat, me paga të ulëta dhe mesatare, me asistencë sociale, disa me problem të pazgjidhur strehimi, të pakënaqur me politikat shëndetësore, pensionale, të sigurisë, të arsimimit etj. Sipas të dhënave nga EUROSTAT lidhur me kërkesat për azil në vendet e BE-së për vitet 2013 dhe 2014, numri i kërkesave nga Kosova janë 20.225 gjatë vitit 2013, të dhëna të cilat e kanë radhitur Kosovën në vendin e gjashtë të vendeve jashtë BE-së qytetarët e të cilës kanë kërkuar azil, ndërsa në vitin 2014 është shënuar një rritje e konsiderueshme e kërkesave nga qytetarët e Kosovës në vendet e BE-së me gjithsej 37.895, duke e radhitur Kosovën në vendin e tretë për nga numri i kërkesave për azil, menjëherë pas qytetarëve nga Siria dhe Afganistani. Shprehur në përqindje 6.1% e të gjitha kërkesave të parashtruara për azil në vendet e BE-së janë paraqitur nga qytetarët e Republikës së Kosovës.¹⁰¹

Sipas të dhënave nga EUROSTAT trendi i kërkesave për azil në vendet e BE-së nga qytetarët e Republikës së Kosovës ka vazhduar me ritëm të shtuar edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2015, veçanërisht gjatë muajit Shkurt, janë regjistruar 22.460 kërkesa për azil. Gjatë këtij tremujori Kosova është radhitur në vendin e parë për nga numri i kërkesave për azil nga qytetarët e saj, duke lënë prapa edhe qytetarët nga vendet si Siria dhe Afganistani. Mirëpo gjatë tremujorit të dytë të vitit 2015 është shënuar një rënie rapide e numrit të kërkesave për azil në vendet e BE-së nga shtetasit e Kosovës¹⁰².

¹⁰⁰ . Po aty faqe, 31.

¹⁰¹ . [http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/File:Countries_of_origin_of_\(non-EU\)_asylum_seekers_in_the_EU-28_Member_States,_2013_and_2014_YB15_III.png](http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/File:Countries_of_origin_of_(non-EU)_asylum_seekers_in_the_EU-28_Member_States,_2013_and_2014_YB15_III.png)

¹⁰² . [http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/File:Countries_of_origin_of_\(non-EU\)_asylum_seekers_in_the_EU-28_Member_States,_2013_and_2014_YB15_III.png](http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/File:Countries_of_origin_of_(non-EU)_asylum_seekers_in_the_EU-28_Member_States,_2013_and_2014_YB15_III.png)



Grafi 5. Trendi i kërkesave për azil në vendet e BE-së nga shtetasit e Kosovës Prill 2014 Qershor 2015

4.4. Kontrabanda me mallra


Kosova si shteti i ri është edhe njëri nga shtetet më të vogla si për nga madhësia ashtu edhe për nga ndikimi i saj ekonomik në rajon. Si shkak i mungesës së zhvillimit të brendshëm ekonomik, gjegjësisht mungesës së sektorit të prodhimit dhe industrisë, sektorë këto që nuk arrijnë t'i plotësojnë as për së afërmi nevojat e konsumit të brendshëm, konsum ky i cili mbulohet kryesisht nga importet. Në Kosovë dhe në vendet e rajonit ende ekzistojnë mundësitë e hapura për tregtinë e paligjshme dhe kontrabandën e mallrave me akcizë (alkool, kafe, cigare, derivate naftës dhe produkte farmaceutike etj), si dhe mallra të tjera të falsifikuara, për shkak të standardit të ulët ekonomik dhe fuqisë së ulët blerëse të popullsisë, e cila favorizon rritjen e tregut të zi dhe kontrabandimin e mallrave. Kontrabandimi i mallrave është kryer pothuajse në të gjitha zonat kufitare të Kosovës me shtetet fqinje por kontrabanda me e madhe është kryer në pjesën veriore të vendit, kufiri me Serbinë.¹⁰³ Kontrabandimi i mallrave shkakton pasoja të mëdha në shoqëri në shumë aspekte të jetës, sidomos në aspektin ekonomik, politik dhe në atë shëndetësor, ndërsa në anën tjetër, grupet e organizuara kriminale kanë përfitime të mëdha nga ky lloj i krimit, pasi që përfitojnë mjete të konsiderueshme financiare duke ju shmangur tatimit, akcizës dhe tarifave doganore.¹⁰⁴

¹⁰³ . [http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/File:Countries_of_origin_of_\(non-EU\)_asylum_seekers_in_the_EU-28_Member_States,_2013_and_2014_YB15_III.png](http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/File:Countries_of_origin_of_(non-EU)_asylum_seekers_in_the_EU-28_Member_States,_2013_and_2014_YB15_III.png)


¹⁰⁴ . <http://www.telegrafi.com/suedia-kerkon-specialiste-ne-profesionet-me-te-kerkuara-paga-mesatare-2730-eurone-muaj/>



Grafikoni 6 - Kontrabanda e derivateve (Nafta, Benzina, Vajra motorik/hidraulike), viti 2012 - Tetor 2015.¹⁰⁵



Grafikoni 7 – Numri i rasteve me kontrabandat të medikamenteve mjekësorë periudha kohore 2012-tetor 2015.¹⁰⁶



Grafikoni 8- Sasia e cigareve të kontrabanduara 2012 – tetor 2015.¹⁰⁷

¹⁰⁵ . Vlerësimi i kërcënimit nga krimet e rënda dhe krimi i organizuar– SOCTA, faq. 46, Prishtinë, Prill, 2016.

¹⁰⁶ . Vlerësimi i kërcënimit nga krimet e rënda dhe krimi i organizuar– SOCTA, faq. 47, Prishtinë, Prill, 2016.

¹⁰⁷ . Vlerësimi i kërcënimit nga krimet e rënda dhe krimi i organizuar– SOCTA, faq. 47, Prishtinë, Prill, 2016.

4.5. Korrupsioni dhe pastrimi i parave

Republika e Kosovës ka bazë të mjaftueshme ligjore për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, megjithatë sipas shumë raporteve, publikimeve dhe hulumtimeve të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare vlerësohet se edhe më tutje niveli i korrupsionit në Republikën e Kosovës mbetet i lartë. Sipas statistikave të Policisë së Kosovës lidhur me rastet e korrupsionit, vërehet pothuajse numër relativisht i njëjtë nga viti në vit, megjithatë gjatë vitit 2015 në krahasim me vitin 2014 shihet një ngritje e lehtë e rasteve të korrupsionit të iniciuara nga Policia e Kosovës. Numri i rasteve dhe personave ndaj të cilëve është ngritur kallëzim penal gjatë vitit 2015 është më i ulët se sa në vitin 2013. Niveli i raportimit dhe detektimit të rasteve të korrupsionit dhe shpërlarjes së parasë mbetet mjaft i ulët, si rezultat i mos gatishmërisë së qytetarëve për raportimin e këtyre rasteve, posaçërisht duke marrë parasysh që korrupsioni nga një pjesë e shoqërisë llogaritet si e vetmja mënyrë për të përfituar benefite.¹⁰⁸

Statistika e veprave penale te korrupsionit	2012	2013	2014	2015
Numri i kallëzimeve penale	139	236	96	154
Numri i personave te arrestuar	65	69	65	67

Tabela 18. Veprat penale të korrupsionit periudha kohore 2012-2015.¹⁰⁹

Shpërlaja e Parasë.- Kosova sikur dhe vendet e tjera te rajonit është e prekur nga fenomeni i shpërlarjes së parave, posaçërisht duke pasur parasysh ekzistimin në masë të madhe të ekonomisë joformale, dhe formave te tjera te aktivitetit kriminal qe posaçërisht zhvillohen në shtetet fqinje, paratë përfundojnë në Kosovë, apo anasjelltas. Bazuar në rastet e raportuara dhe te hetuara në Policinë e Kosovës për periudhën 2014 dhe 2015 lidhur me shpërlarjen e parave si dhe në kallëzimet penale të dërguara në prokuroritë kompetente, vërehen disa mënyra të kryerjes së kësaj vepre penale ku kryesisht parat e përfituara nga aktiviteti kriminal transferohet përmes llogarive bankare të personave fizik apo juridik në disa shtete duke përdorur vende “off show” dhe duke hapur biznese fiktive në këto shtete pa realizuar kurrfarë aktivitet biznesi.¹¹⁰

Statistika e PK	2012	2013	2014	2015
Numri i kallëzimeve penal	3	4	2	4
Numri i personave te arrestuar	7	0	0	2
Numri i te dyshuarave	14	6	6	27

¹⁰⁸. Po aty, faqe, 48.

¹⁰⁹. Vlerësimi i kërcënimit nga krimet e rënda dhe krimi i organizuar– SOCTA, faq. 49, *Prishtinë, Prill, 2016*.

¹¹⁰. Po aty, faq, 49

Tabela 19 - Statistikat e veprës penale Pastrim i parasë 2012-2015. ¹¹¹

Paratë e pastruara që rrjedhin nga aktiviteti kriminal kryesisht përfundojnë në: a) Investime ne prona te paluajtshme, b) ndërtimtari, c) hoteleri, d) vetura, e) hapjen e veprimtarive te ndryshme biznesorë apo f) vazhdimin e bizneseve aktuale, g) Shpenzime jetësore etj. ¹¹² Bazuar në të dhënat e lartshënuar në Kosovë ka lulëzuar ekonomi informale, investimet janë kryesisht në investime ne prona te paluajtshme, ndërtimtari, hoteleri, vetura të shtrenjta e luksoze, hapjen e veprimtarive të ndryshme biznesore etj.

4.7. Armët ilegale-kontrabanda me armë

Veprat penale kontrabandimi me armë, mbajtja në pronësi e armëve si dhe përdorimi kundërligjor i tyre janë karakteristikë e rajonit dhe e popujve të Ballkanit, rajon në të cilin bënë pjesë edhe Kosova. Numri i armëve në duart e popullatës kosovare llogaritet të jetë ende i madh edhe pse policia në vazhdimësi që nga paslufta e këndeje ka konfiskuar numër të madh të këtyre armëve. Sipas disa hulumtimeve thuhet se në posedim të qytetarëve mund të jenë rreth 350.000. ¹¹³ Këto armëve kryesisht janë armë të mbetura nga lufta e fundit në Kosovë, ku një sasi e konsiderueshme e tyre janë gjetur në depo të braktisura ushtarake të ushtrisë Jugosllave, por edhe në shtëpi banimi të personave të cilët pas përfundimit të luftës kanë lëshuar Kosovën. Gjithashtu sipas informacioneve, armët e kontrabanduara hyjnë e dalin nga Kosova përmes të gjitha vendeve fqinje dhe në të gjitha këto vende kontrabanduesit kosovarë edhe blejnë edhe shesin armë. Kjo gjë ndodh për shkak të specifikave të grupeve kontrabanduese, pra varësisht se ku ata gjejnë oferta më të mira për treg të armëve. Kjo tregon se dukuria e kontrabandimit të armëve në rajonin e Ballkanit është shumë e përhapur dhe bashkëpunimi i grupeve kriminale është shumë i madh, përfshirë këtu edhe bashkëpunimin në mes kontrabanduesve shqiptarë dhe serb. Përveç kontrabandimit të armëve nga Shqipëria, Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia, armët në Kosovë kontrabandohen edhe nga Turqia, Bullgaria, Italia, Austria, Belgjika, Çekia etj. Bazuar në të dhënat policore nga hetimet e rasteve të posedimit të paautorizuar të armëve, rezultojnë që armët e prodhuara në ish Jugosllavi (revole të modelit TT dhe armë automatike AK47) janë më të shpeshtat. Kontrabanduesit e armëve në të shumtën e rasteve sjellin armë sipas kërkesave që marrin nga klientët e tyre, të cilat i fusin në Kosovë përmes rrugëve tokësore

¹¹¹ . Po atu faqe, 50

¹¹² . Vlerësimi i kërcënimit nga krimet e rënda dhe krimi i organizuar– SOCTA, faq 51, *Prishtinë, Prill, 2016*.

¹¹³ . Sipas një hulumtimi nga UNDP të realizuar në vitin 2012 vlerësohet se në Kosovë janë rreth 350.000 armë të vogla dhe të lehta. Në këtë shifër janë të përfshira edhe numri i armëve legale që janë në dispozicion të institucioneve të rendit.

nga vendet e rajonit me anë të mjeteve të ndryshme transportuese si vetura, kamion, autobus etj. Shumë herë vërehet keqpërdorimi i bizneseve legale shitëse apo transportuese të cilat përveç punës legale kryejnë edhe aktivitete kriminale të shitjes së armëve dhe municionit. Kërcënim për qytetarët e Kosovës, por edhe për institucionet e vendit, veçmas atyre të sigurisë vazhdojnë të jenë armët ilegale të cilat gjenden në duar të qytetarëve.¹¹⁴

¹¹⁴ . Vlerësimi i kërcënimit nga krimet e rënda dhe krimi i organizuar– SOCTA, faq 58, Prishtinë, Prill, 2016.

Kapitulli V

5. Perceptimet e Opinionit Publik të Kosovës

Perceptimi është proces psikik i njeriut, në kontekstin e punimit të tezës së magistraturës do të vlerësohen perceptimet dhe qëndrimet e opinionit publik të Kosovës mbi ekspansionin e krimit të organizuar nacional dhe transnacional, dhe në bazë të rezultateve të studimit do të jepen rekomandime. Pra, siç potencuam më lartë perceptimet janë procese psikike të individit për fenomenet shoqërore, individ, institucione, të cilat formohen nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm: familjes, mediave, edukimit, arsimimit, shoqërisë që mund të shndërrohen në perceptime të përgjithshme, të cilat mund të jenë paragjyquese, përjashtuese, stigmatizuese. Në perceptimet e opinionit publik ndikojnë shumë faktor si ata individual (të brendshëm) si dhe faktorët social-shoqëror (të jashtëm), nga më të rëndësishmit ndër këta është kognicioni social. Kognicioni social është të kuptuarit e vetes dhe të tjerëve.¹¹⁵

5.1. Perceptimet e Personave (njerëzve)

Shumica e njerëzve kanë një aftësi të habitshme për të njohur dhe reaguar ndaj, fenomeneve shoqërore, individëve dhe institucioneve shoqërore apo edhe ndaj personalitetit të dikujt tjetër. Kur takojmë një njeri për herë të parë, kur gjendemi në situata të ndryshme sociale, ne nxitojmë të përcaktojmë me anë të procesit të formimit të përshtypjeve nëse i pëlqejmë ata/ato apo/jo. Madje ne marrim informacione të ndryshme edhe dëgjimi i një grimce të informacionit për gjëra të ndryshme për dikë ose thjesht shikimi i tij, na lejon të gjykojmë rreth tij. Solomon Asch (1955) mbështeti idenë se ne i perceptojmë njerëzit si tërësi.¹¹⁶ Kështu kur kemi vetëm një informacion të pjesshëm, ne priremi t'i mbushim boshllëqet e përshtypjeve tona me tipare njerëzish të ngjashme me ata/ato që ne perceptojmë. Procesi i perceptimit të personit ka të bëjë me përdorimin e informacionit që grumbullojmë për të formuar përshtypjet për njerëz e për t'i vlerësuar ata/ato institucione, individ, gjësende etj. Sipas Asch perceptimi është proces edhe i interpretimit të ndijimeve.¹¹⁷ Megjithatë në procesin e perceptimit të personit, dukurive, institucioneve ndijimet dhe informacionet ne marrim burimin e sjelljeve dhe karakteristikat e njerëzve rreth nesh. Osgood, Suci dhe Tannenbaum (1975) përpunuan procedurën e diferencimit semantik gjatë së cilës iu kërkuan subjekteve të vlerësojnë persona dhe objekte duke zgjedhur se cila nga çiftet e tipareve ishin më përshkruese. Ata zbuluan se tri përmasat ishin shumë të rëndësishme në klasifikimin e njerëzve: vlerësimi; (i mirë-i keq), fuqia; (i fortë-i dobët), dhe veprimtaria; (aktiv-pasiv).

¹¹⁵ . Fiske and Taylor, 1984

¹¹⁶ . Asch, S.E. (1955). "Opinions and social pressure". *Scientific American*. 193 (5): 31–35. doi:10.1038/scientificamerican1155-31.

¹¹⁷ . Asch, S.E. (1955). "Opinions and social pressure". *Scientific American*. 193 (5): 31–35. doi:10.1038/scientificamerican1155-31.

Ata mbështeten idenë së vlerësimi ishte përmasa më e rëndësishme për formimin e një përshtypje për njerëzit tjerë.¹¹⁸ Përshtypja e parë, për të përcaktuar se çfarë ka më shumë rëndësi në formimin e përshtypjeve që veprojnë për një kohë të gjatë, mbi përshtypjen e parë apo përshtypjen e fundit, janë kryer shumë studime. Në studimin të cilin e bëri S. Asch (1946) ai bëri të ditur se subjektet që i dëgjonin karakteristikat e personalitetit të dikujt që ishin përshkruar si “inteligjent, i zellshëm, impulsiv, kritik, kokëfortë, dhe ziliqar” e konsideronin këtë dukshëm si më të lumtur e më social nga ç’ë konsideronin subjektet tjera, që i dëgjojmë, po këto tipare por me renditje të kundërt. Siç duket, faljet e para që dëgjojmë, çofshin të këndshme (mira apo të këqija) ose të pakëndshme, janë ato që mbahen mend dhe që ndikojë mbi perceptimet dhe sjelljet tona. Në një eksperiment klasik të zhvilluar nga Harolld Kelley (1950) me një grup studentësh ai i informoj se lektori i ri ishte “një njeri i ngrohtë, zellshëm, kritik, praktik, dhe me qëllim”. Ata u pyetën si do të reagoni nëse ky person vinte për t’i bërë leksion grupit të tyre. A do të prireshit të bashkëvepronin më të apo do të rrinin në punën e tyre? Kelley zbuloi se 56% të studentëve u angazhuan në diskutime me lektorin dhe shumica dërmuese e tyre e klasifikuan atë si të ditur, të vëmendshëm, shoqëror, të afrueshëm, fisnik, dhe me humor. Një grupit tjetër të studentëve iu tha se i ardhuri ishte “një person disi i ftohtë, i zellshëm, kritik, praktik dhe me qëllim”. Ata u pyetën se si do të reagoni. Kelley zbuloi se vetëm 32% të subjekteve morrën pjesë në diskutimet shumica e klasifikuan lektorin si egocentrik, zyrtar, joshoqëror, grindës dhe pa humor. Dhe krejt qartë se ndryshimi i vetëm ishte zëvendësimi i fjalës “i ngrohtë” me fjalën “i ftohtë”, në përshkrimin që iu bë lektorit. Përshtypjet tona të para ndikojnë mbi sjelljet tona, qëndrueshmëria dhe pre dispozicioni i pozitivitetit.¹¹⁹ Studimet kanë treguar se me të formuar një përshtypje të përgjithshme për dikë, ne priremi ta interpretojmë gjithë informacionin tjetër për atë person në përputhje me përshtypjen tonë të përgjithshme. Në këtë mes vihet re qëndrueshmëri në përshtypjet që kemi. Efekti Halo (Efekti Halo i përshtatet në mënyrë të përkryer situatës së famshme të Hollivudit, ku njerëzit me lehtësi supozojnë se meqë këta njerëz janë fizikisht tërheqës, vijon se ato janë inteligjentë, miqësore dhe shfaqin gjithashtu një gjykim të mirë). Kjo vlen edhe për njerëzit e tjerë të mirënjohur si politikanët u dëshmuar me një studim të zhvilluar në vitin 1977 nga Richard Eugene Nisbett dhe 1977, *Psychological Review*, 84, 231–259) mbi personalitetin e presidentit Willson. Këta eksperimentues u dhanë studentëve të shihnin videokasetën e një profesori. Në njërin version, profesori ishte i ngrohtë dhe miqësor, ndërsa në versionin tjetër ishte i ftohtë dhe i pakujdesshëm. Studentet që panë versionin e parë e pëlqyen profesorin më shumë dhe i vlerësuan të gjitha karakteristikat

¹¹⁸ . KELLEY, H.H. (1959) *THE SOCIAL PSYCHOLOGY OF GROUPS*. NEW YORK: WILEY

¹¹⁹ . Kelley, H.H. (1959) *The social psychology of groups*. New York: Wiley.

e tij në një mënyrë më pozitive se subjektet që panë versionin e dytë (profesorin e vlerësuan si të ftohtë).¹²⁰ Nga ajo që u potencua mbi studimet e zhvilluara deri me tani mbi perceptimet e individëve (opinionit) mund të konkludojmë se rëndësi të veçantë në perceptimet e opinionit mbi fenomene të veçanta shoqërore e në këtë rast mbi ekspansionin e krimit të organizuar rol vendimtar në perceptimet e tyre ka pasur informacioni mbi fenomenin e krimit të organizuar. Kur vlerësojmë të tjerët (fenomenet sociale) ne priremi gjithashtu të shfaqim pre dispozicion në perceptimin e personit, fenomenit dhe këtë e bëjmë duke bërë më shumë vlerësime pozitive se sa negative (Sears, 1983). Prija për t'i vlerësuar të tjerët pozitivisht quhet pre dispozicion i pozitivitetit të tjetrit. Sears në një studim bëri të ditur se studentët i klasifikuan 97% të profesorëve si mbi mesatar (në fakte, vetëm 50% janë nën mesatarë). Ne i simpatizojmë njerëzit, dhe kështu i vlerësojmë ata më lartë kur janë individë se sa kur janë në grupe. Kjo dëshmon ndikimin e elementit njerëzor në vlerësime, përderisa profesori dhe lënda ofrojnë eksperiencë të njëjta. Përshtypja e parë që formojmë për dikë priret të jetë faktor dominues në interpretimin e përshtypjeve të mëvonshme.¹²¹

5.2. Qëndrimet

Në mund të miratojmë personalitetin e Presidentit, Kryeministrit, institucioneve të ndryshme, fenomeneve të ndryshme sociale etj, por mund të mos miratojmë politikën e tij/tyre, ose mos të vlerësojmë pozitiv një fenomen, dukuri sociale. Prijet tona të ndjenjave, mendimeve dhe sjelljeve tona ndaj njerëzve, situatave, institucioneve, dukurive, personaliteteve përbëjnë qëndrimet tona. Qëndrimet janë pre dispozicione të mësuara që na udhëheqin aktivisht drejt sjelljeve specifike. Patty dhe Cacioppo 1985 hodhën idenë se qëndrimet janë vlerësime të përgjithshme për njerëzit, dukuri, institucionet, dhe probleme dhe ato jetojnë për një kohë të gjatë, të cilat janë të lidhura me ndjenjat, sjelljen dhe kognicionin. Përbërësi i ndjenjës ka të bëjë me reagimin tonë emocional. Përbërësi i sjelljes ka të bëjë me veprimet tona, të cilat bartin vlerësimet që kemi. Përbërësi kognitiv ka lidhje me aspektin e të menduarit për formimin e një qëndrimi. Ndjenjat, sjellja dhe kognicioni janë të pranishme pothuajse në çdo qëndrim që mbajmë.¹²² Qëndrimet tona ndonjë herë mund të jenë të paarsyeshme. Përbërësi kognitiv mund të bazohet në argumente faktike ose në ide pa bazë të cilat i kemi marrë nga njerëzit tjerë pa i analizuar. Përbërësi emocional mund të bazohet në përvojën personale të drejtpërdrejtë.

¹²⁰ . Nisbett, R. E. & W. T. D., 1977, *Psychological Review*, 84, 231–259),

¹²¹ . Patty Petergjon *Psikologjia (Nje hyrje koncize)*, Lilo, Tiranë, 1996, faq, 530

¹²² . Cacioppo, John; Cole, Steve; Hawkley, Louise; Arevalo, Jesusa; Sung, Caroline; Rose, Robert (September 2007). "Social regulation of gene expression in human leukocytes". *Genome Biology*. Biomed Central Ltd. 8 (9): R189. doi:10.1186/gb-


Kapitulli VI

Pjesa Empirike e Studimit

6. ANALIZA E REZULTATEVE TË HULUMTIMIT

Çështja e perceptimit, besimit dhe bindjes së qytetarëve për institucionet në luftimit të krimit të organizuar, sistemit të drejtësisë dhe sistemit të sigurisë së Kosovës, është fokus i hulumtimit empirik, perceptimi është proces psikologjik i cili zhvillohet gradualisht me zhvillimin intelektual, mendor të individit, i kushtëzuar me preokupimet dhe interesin e individit mbi çështje, tema të ndryshme. Shumica e njerëzve kanë një aftësi të habitshme për të njohur dhe reaguar ndaj fenomeneve shoqërore, individëve, institucioneve, uniformave apo të karakteristikave të rëndësishme të personalitetit të dikujt tjetër. Perceptimet tona në fazën fillestare, mbi fenomenet shoqërore apo situata të ndryshme sociale nxitojmë të përcaktojmë me anë të procesit të formimit të përshtypjeve fillestare nëse i pëlqejmë ata apo jo. Me pas ne marrim informacione të ndryshme edhe dëgjimi i një grimce të informacionit për gjera të ndryshme për dukuri apo dikë ose thjesht shikimi i tij, na lejon të gjykojmë rreth tij. Siç duket, fjalët e para që dëgjojmë, nga individët mbi fenomene apo individ të ndryshëm janë: qofshin të këndshme (mira apo të këqija) ose të pakëndshme, janë ato që mbahen mend dhe që ndikojnë mbi perceptimet dhe sjelljet tona. Perceptimet, besimi dhe bindjet tona mbi ekspansionin e krimit të organizuar nacional dhe transnacionalë, ndikohen nga shumë faktorë duke filluar nga njohuritë, përvoja, informatat, mas-mediat, opinionin publik, ato formohen gradualisht por që nuk ndryshojnë shpejtë. Njerëzit janë të ndikuar në perceptimet, besimet dhe bindjet e tyre personale. Në vazhdim do të pasqyrojmë opinionet e qytetarëve mbi perceptimet, qëndrimet e opinionit publik të Kosovës mbi krimin e organizuar nacional dhe transnacional.


1. Vlerësimi juaj për veprat e kryera nga krimi i organizuar në Kosovë



Grafikoni nr. 9. Si i vlerësoni veprat e kryera nga krimi i organizuar?

Në grafikonin nr.9 janë të pasqyruara perceptimet, mendimet e opinionit publik mbi vlerësimin e veprave kriminale të krimit të organizuar në Kosovë, perceptimet e opinionit janë si në vijim: 50% e të anketuarve të opinionit publik veprat e krimit të organizuar i klasifikojnë, si vepra shumë kriminale, 20% e të anketuarve veprat e krimit të organizuar i klasifikojnë mesatarisht kriminale, 17% e të anketuarve veprat e krimit të organizuar i klasifikojnë pak kriminale, ndërkaq 5% e të anketuarve s’kam përgjigje.


2. Perceptimi juaj, a luftohet në mënyrë efektive krimi i organizuar në Kosovë?



Grafikoni nr. 10. Perceptimi juaj, a luftohet në mënyrë efektive krimi i organizuar në Kosovë?

Në grafikonin nr.10. janë të pasqyruar perceptimet e opinionit publik mbi luftimin e krimit të organizuar në Kosovë në mënyrë efikase, perceptimet janë si në vijim; 50% e të anketuarve mendojnë se krimi i organizuar në Kosovë nuk luftohet në mënyre efektive;25% e të anketuarve mendojnë se krimi i organizuar në Kosovë luftohet pjesërisht në mënyre efektive; 17% e të anketuarve mendojnë se krimi i organizuar në Kosovë luftohet në mënyre të plotë; kurse 8% e të anketuarve pohojnë s’ di.

3. Perceptimi juaj mbi kolaborimin në mes të krimit të organizuar kombëtar dhe atij ndërkombëtar



Grafikoni nr.11. perceptimet e opinionit mbi kolaborimin në mes të krimit të organizuar kombëtar dhe atij ndërkombëtar?

Në grafikonin nr.11. janë prezantuar perceptimet e opinionit publik të Kosovës mbi kolaborimin e krimit kombëtar dhe ndërkombëtar, perceptimet e opinionit publik të Kosovës janë si në vijim; 49% e të anketuarve mendojnë se kolaborimi në mes të krimit të organizuar kombëtar dhe ndërkombëtar është shumë i lartë; 24% e të anketuarve mendojnë se kalaborimi në mes të krimit të organizuar kombëtar dhe ndërkombëtare është mesatar;18% e të anketuarve mendojnë se kolaborimi në mes të krimit të organizuar kombëtar dhe ndërkombëtar është i ultë; ndërsa 10% e të anketuarve pohojnë s’kam ide mbi bashkëpunimin në mes të krimit të organizuar kombëtar dhe ndërkombëtar.


4. Perceptimi juaj mbi ekspansionin e krimit të organizuar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar



Grafikoni nr.12. Perceptimi juaj, mbi ekspansionin e krimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar?

Në grafikonin nr.12. janë të prezantuara perceptimet e opinionit publik në Kosovë mbi ekspansionin e krimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, perceptimet e opinionit janë si në vijim; 51% e të anketuarve mendojnë se krimi i organizuar si në nivelin kombëtar edhe në nivelin ndërkombëtar ka pasur një ekspansion të lartë; 25% e të anketuarve mendojnë se gjatë këtyre viteve të fundit krimi i organizuar si ai në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel ndërkombëtar ka pasur ekspansion mesatar; 20% e të anketuarve janë shprehur se krimi i organizuar kombëtar dhe ndërkombëtar ka pasur ekspansion të ultë; ndërkaq 4% e të anketuarve janë shprehur s’kam ide mbi krimin e organizuar.

5. Perceptimi juaj mbi ekspansionin e krimit të organizuar në Kosovë



Grafikoni nr.13. perceptimet mbi ekspansionin e krimit të organizuar në Kosovë?

Në grafikonin nr. 13. janë të prezantuar perceptimet e opinionit publik të Kosovës mbi ekspansionin e krimit të organizuar në Kosovë, perceptimet janë si në vijim: 45% e të

anketuarve kanë pohuar se ekspansioni i krimit të organizuar në Kosovë është shumë i lartë, 29% e të anketuarve mendojnë se ekspansioni i krimit të organizuar në Kosovë është mesatar, 18% e të anketuarve mendojnë se ekspansioni i krimit të organizuar në Kosovë është mesatar, 8% e të anketuarve pohojnë s’ di.


6. Sa është shteti i Kosovës i organizuar në luftimin e krimit të organizuar



Grafikoni nr.14. Sa është shteti i Kosovës i organizuar në luftimin e krimit të organizuar?

Në grafikonin nr.14. janë pasqyruar perceptimet e opinionit publik të Kosovës mbi atë se sa është i organizuar shteti i Kosovës në luftimin e krimit të organizuar, perceptimet e opinionit janë si në vijim: 45% e të anketuarve mendojnë se shteti i Kosovës nuk është i organizuar aspak në luftimin e krimit, 30% e të anketuarve mendojnë se shteti i Kosovës është i organizuar pak në luftimin e krimit të organizuar, 19% e të anketuarve mendojnë se shteti i Kosovës është i organizuar shumë në luftimin e krimit të organizuar në Kosovë si dhe 6% e të anketuarve shprehen s’ di.


7. Sa janë të organizuar institucionet e sigurisë dhe drejtësisë të Kosovë në luftimin e krimit të organizuar



Grafikoni nr.15. Sa janë të organizuar institucionet e sigurisë dhe drejtësisë të Kosovë në luftimin e krimit të organizuar?

Në grafikonin nr.15. janë të pasqyruara perceptimet e opinionit publik të Kosovës mbi interesimin dhe organizimin e institucionet e sigurisë dhe drejtësisë në ndalimin e ekspansionit të krimit të organizuar në Kosovë, perceptimet janë si në vijim; 48% e të anketuarve mendojnë se institucionet e sigurisë dhe të drejtësisë janë pak të interesuar-organizuar në luftimin e krimit të organizuar; 20% e të anketuarve mendojnë se institucionet e sigurisë dhe drejtësisë aspak nuk janë të interesuar-organizuar në luftimin e krimit të organizuar; 18% e të anketuarve mendojnë se institucionet e sigurisë dhe drejtësisë janë të interesuar-organizuar në luftimin e krimit të organizuar në Kosovë; si dhe 14% e të anketuarve pohuan s’di.

8. Besim juaj në institucionet e drejtësisë dhe të sigurisë në luftimin e krimit të organizuar?



Grafikoni nr. 16. Besimi juaj në institucionet e sigurisë dhe drejtësisë në luftimin e krimit të organizuar?

Në grafikonin nr.16. janë të shprehur besimi në institucionet e sigurisë dhe drejtësisë në luftën e tyre kundër krimit të organizuar në Kosovë, besimi i shprehur i opinionit është si në vijim: 21% e të anketuarve shprehin besim shumë të lartë në institucionet e sigurisë dhe drejtësisë në luftimin e krimit të organizuar, 39% e të anketuarve kanë shprehur besim mesatar në institucionet e sigurisë dhe drejtësisë në luftimin e krimit të organizuar në Kosovë, 30% e të anketuarve kanë besim të ulët në institucionet e sigurisë dhe drejtësisë në luftimin e krimit të organizuar ndërkaj 10% e të anketuarve kanë pohuar s’di.

9. Perceptimi juaj mbi funksionimin e krimi të organizuar në Kosovë



Grafikani nr.17. Perceptimi juaj mbi funksionimin e krimi të organizuar në Kosovë

Në grafikonin nr.17. Pasqyrohen perceptimet e opinionit publik të Kosovës mbi funksionimin, organizimin e krimi të organizuar, perceptimet e qytetarëve janë shprehur si në vijim: 49% e të anketuarve janë shprehur se krimi i organizuar në Kosovë funksionon në mënyrë shumë të organizuar, 21% e të anketuarve janë shprehur se krimi i organizuar funksionon në mënyrë mesatarisht të organizuar, 19 % e të anketuarve mendojnë se krimi në Kosovë funksionon në mënyrë pak të organizuar si dhe 11 % e të anketuarve mendojnë se krimi i organizuar nuk është fare i organizuar.

10. Perceptimi juaj, ndikimi i krimi të organizuar në sistemin politikë të Kosovës



Grafikoni nr.18. Perceptimi juaj, ndikimin i krimi të organizuar në sistemin politik të Kosovës?

Në grafikonin nr.18. janë pasqyruar perceptimet e opinionit publik të Kosovës mbi ndikimin e krimi të organizuar në sistemin politik të Kosovës, perceptimet e shprehur janë si në vijim: 52% e të anketuarve mendojnë se krimi i organizuar ka ndikim të lartë në sistemin politik të Kosovës, 27% e të anketuarve mendojnë se krimi i organizuar ka ndikim mesatar në sistemin

politik të Kosovës, 11% e të anketuarve mendojnë se krimi i organizuar ka ndikim të ulët në sistemin politik të Kosovës si dhe 10 % e të anketuarve shprehen s’ di.


11. Sipas mendimit tuaj, cila nga këto forma të krimit të organizuar është më e përhapur në Kosovë?



Grafikoni nr.19. Sipas mendimit tuaj, cila nga këto forma të krimit të organizuar është më e përhapur në Kosovë?


Në grafikoni nr. 19. janë pasqyruar mendimet e opinionit publik të Kosovës mbi format më të përhapura të krimit të organizuar në Kosovë, mendimet e shprehura janë si në vijim: 41 % e të anketuarve janë shprehur se korrupsioni është një nga format e krimit më i përhapur në Kosovë, 23% e të anketuarve janë shprehur se kontrabanda me lëndë narkotike është forma më e përhapur e krimit të organizuar në Kosovë, 20% e të anketuarve janë shprehur se evazioni fiskal dhe pastrimi i parave janë një nga format më të përhapura të krimit të organizuar në Kosovë, 10% e të anketuarve mendojnë se trafikimi me armë dhe qenie njerëzore është një nga format e krimit të organizuar më i përhapur në Kosovë, si dhe 10% e të anketuarve shprehin mendime të tjera.

12. Perceptimi juaj, sa paraqet rrezik krimi i organizuar për të ardhmen e Kosovës?



Grafikoni nr.20. Perceptimi juaj, sa paraqet rrezik krimi i organizuar për të ardhmen e Kosovës?

Në grafikonin nr.20. janë pasqyruar perceptimet e opinionit publik mbi rreziqet që paraqet krimi i organizuar për të ardhmen e Kosovës, opinionet e të anketuarve janë si në vijim: 59% e të anketuarve mendojnë se krimi i organizuar paraqet rrezik shumë të lartë për të ardhmen e Kosovës, 19 % e të anketuarve mendojnë se krimi i organizuar paraqet pak rrezik për të ardhmen e Kosovës, 15 % e të anketuarve mendojnë se krimi i organizuar nuk paraqet aspak rrezik për të ardhmen e Kosovës, 7% e të anketuarve shprehen s’di.



Grafikoni nr.21. Perceptimi juaj, mbi lidhjen e mundshëm të segmenteve të caktuara të politike(shtetërore) me krimin e organizuar në Kosovë?

Në grafikonin nr.21. prezantohen perceptimet e opinionit publik mbi lidhjen e mundshme të segmenteve të caktuara politike(shtetërore) me krimin e organizuar në Kosovë, perceptimet e opinionit publik janë si në vijim: 39% e të anketuarve shprehin mendimin e tyre se segmentet e caktuara politike(shtetërore) në Kosovë kanë lidhje të lartë me krimin e organizuar, 28% e të anketuarve shprehin mendimin e tyre se segmentet e caktuara politike(shtetërore)në Kosovë kanë lidhje mesatare me krimin e organizuar, 20% e të anketuarve shprehin mendimin e tyre se segmentet e caktuara politike (shtetërore)në Kosovë kanë lidhje të ulët me krimin e organizuar, 13% e të anketuarve shprehin mendimin e tyre se segmentet e caktuara politike(shtetërore)në Kosovë s’di a kanë lidhje me krimin e organizuar.

Kapitulli VII

7. Rekomandimet e politikave

